

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

28 NËNTOR 2003

P. No. 17/02

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut të Gjilanit në kolegjin e përbërë prej Timothy Clayson, Kryetari i Trupit Gjykses, Gjykatësi Ndërkombëtar Vinod Boolell dhe Gjykatësi Profesionist Fahredin Ymeri, të asistuar prej Proçes-mbajtëset Cecila Takoff dhe Robina Struthers në çështjen penale kundër të akuzuarit Momçilo Trajkoviç nga fshati Caracovc (Komuna e Kamenicës), i akuzuar për kryerjen e Krimeve të Luftës të përkufizuar dhe ndëshkuar mbi bazën e Nenit 142 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë, për dy krime të Vrasjes në Tentativë të përkufizuar dhe ndëshkuar nga Neni 30, paragrafi 1 i Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me Nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë, dhe krimin e Armëmbajtjes pa leje të përkufizuar dhe ndëshkuar prej Nenit 199, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës, i mbrojtur prej Oliviera Jovanovic nga Subotica dhe Zivojin Jokanovic nga Prishtina, në përputhje me aktakuzën e ngritur prej Prokurorit Publik të Gjilanit, respektivisht atyre me numër No. 84/2000 të datës 3 Prill 2000 dhe No. 115/2000 të datës 21 Shtator 2000 e cila më vonë është amenduar prej Prokurores Publike Ndërkombëtare Cecilia Tillada, seanca e parë gjyqësore u zhvillua më 27 Maj 2002 dhe seancat e mëvonëshme gjyqësore u zhvilluan më 28 Maj, 26 Qershor, 27 Qershor, 28 Qershor, 18 Korrik, 22 Korrik, 23 Korrik, 25 Korrik, 6 Gusht, 6 Shtator, 30 Shtator, 11 Tetor, 17 Tetor, 12 Nëntor, 2 Dhjetor, 17 Dhjetor, 17 Janar 2003, 3 Shkurt, 5 Shkurt, 7 Shkurt, 6 Mars, 7 Mars, 2 Prill, 30 Prill, 27 Maj, 28 Maj 2003 dhe pas përfundimit të gjykimit kryesor të mbajtur në public më 30 Maj 2003, në prani të palëve dhe pas tërheqjes për të marë vendim, shpall këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri Momcilo Trajkovic, emri i babait [REDAKTUAR], emri i nënës [REDAKTUAR] me mbiemër të vajzërisë [REDAKTUAR], lindur më [REDAKTUAR] në fshatin Caracovc, Komuna e Kamenicës, banues i përhershëm në Kamenicë, Sërb, qytetar i Republikës Federale të Jugosllavisë, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka mbaruar shkollën e mesme, ka kryer shërbimin e rregullt ushtarak, në gjendje ekonomike të mesme, pa të kaluar penale, në paraburgim që prej 7 Shtatorit 1999, i liruar në dorëzanësi më 26 Korrik 2002,

LIROHET

Nga veprat penale të krimeve të luftës, sikundër është treguar në Krimet nga numuri 1 deri në atë 11, të përfshirë, në aktakuzën e amenduar të Prokurores Publike Ndërkombëtare të daës 26 Shkurt 2003, dhe të përkufizuar e ndëshkuar prej Nenit 142 të

Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, në përputhje me Nenin 350, paragrafi 3 të Ligjit të Proçedurës Penale.

Dhe është

FAJTOR

1. Më 27 Qershor 1999 në Kamenicë rreth orës 17:00, i akuzuari me qëllim për të vrarë dhe i nisur nga motive të urrejtjes dhe paragjytimeve etnike qëllon mbi M■■■■ F■■■■, ndërsa ai dhe A■■■ P■■■ ishin duke vendosur një flamur Shqiptar në ballë të ndërtesës së Departamentit të Punëve të Brëndëshme dhe gërthiti se si është e mundur që terroristët Shqiptarë të vendosin flamurin Shqiptar atje. I akuzuari më pas qëllon mbi M■■■■ F■■■■ nga ballkoni i tij. M■■■■ F■■■■ u godit dhe u plagos në këmbën e djathtë.

Me anë të kësaj ai ka kryer krimin e vrasjes në tentativë sipas Nenit 30, paragrafi 1 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me Nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë.

Gjykata nuk e mori në konsideratë akuzën e dytë të vrasjes në tentativë ndaj A■■■ P■■■, sepse mbi bazën e Nenit 378 të Ligjit të Proçedurës Penale dhe se principi ligjor bazë të "reformatio in peius" të mund të jetë shkelur meqë apelimi është depozituar vetëm në emër të të akuzuarit, kështu që aktvendimi nuk mundet të modifikohet në kurriz të tij në lidhje me vlersimin ligjor të veprës penale dhe sanksioneve penale ndaj saj.

2. Për akuzën se në një datë të panjohur ai mori një armë automatike, 300 fishekë për këtë armë si dhe dy granada dore dhe i mbajti ato pa lejen përkatëse në apartamentin e tij në Kamenicën e Kosovës deri më 7 Shtator 1999, të cilat qytetarët nuk janë aspak të lejuar ti mbajnë

Me anë të kësaj ai ka kryer krimin e armëmbajtjes pa leje, të përkufizuar dhe ndëshkuar nga Neni 199, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës.

Për këtë arsye mbi bazën e Nenit 351 të Ligjit të Proçedurës Penale, Gjykata cakton në vijim

DËNIMIN

I pandehuri dënohet me burgim për një periudhë prej tre vjetësh për krimin e vrasjes në tentativë duke shkelur Nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me Nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe një dënim prej katër muaj burgim për krimin e armëmbajtjes pa leje duke shkelur Nenin 199, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës.

Gjykata e dënnoj të pandehurin me një dënim total të kombinuar prej Tre vjetësh dhe tre muajsh burgim në përputhje me Nenin 48, paragrafi 1 dhe 2, pika 3.

Dënimi përfshin kohën që i pandehuri ka kaluar tashmë në paraburgimin para-gjyqësor, pikërisht prej 7 Shtatorit 1999 deri më 26 Korrik 2002.

Gjykata urdhëron konfiskimin e pushkës automatike, të 300 fishekëve dhe të dy granadave të dorës në përputhje me Nenin 69 të Ligjit Penal Jugosllav.

I akuzuari do të paguaj gjysmën e shpenzimeve të kësaj procedure penale.

Pala e dëmtuar mundet të paraqesë pretendimet e saja në gjykatën civile.

Në përputhje me vendimin e kësaj Gjykate të datës 26 Korrik 2002 për kohën dhe kushtet e dorëzansisë të cilat i janë imponuar të pandehurit nga vendimi i lartë-përmëndur duhet të mbeten në fuqi derisa ky aktgjykim të marrë formë përfundimtare.

ARSYETIMI

Hyrje

Ky gjykim u zhvillua në vijim të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 30 Nëntor 2001. Me anë të aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme hedh poshtë aktgjykimin e parë të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, në të cilën Momcillo Trajkovic (që tash e mbrapa do të quhet "i pandehuri"), u dënua për veprat penale të Krimeve të Luftës kundër popullsisë civile, vrasjes në tentativë (një akuzë) dhe armëmbajtjes pa leje, dhe për akuzat e mësipërme ai u dënua me njëzet vjet burg.

Gjatë gjykimit u dëgjuan nga gjykata dëshmitarët e mëposhtëm: M [REDACTED] R [REDACTED], R [REDACTED] R [REDACTED], XI [REDACTED] L [REDACTED], N [REDACTED] V [REDACTED], T [REDACTED] I [REDACTED], K [REDACTED] I [REDACTED], F [REDACTED] Sh [REDACTED], B [REDACTED] K [REDACTED], A [REDACTED] R [REDACTED], L [REDACTED] L [REDACTED], B [REDACTED] K [REDACTED], M [REDACTED] F [REDACTED], M [REDACTED] F [REDACTED] K [REDACTED], F [REDACTED] Th [REDACTED], H [REDACTED] Th [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED], B [REDACTED] S [REDACTED], B [REDACTED] K [REDACTED], T [REDACTED] K [REDACTED], Z [REDACTED] I [REDACTED], B [REDACTED] K [REDACTED], B [REDACTED] Xh [REDACTED], B [REDACTED] K [REDACTED], R [REDACTED] B [REDACTED], Sh [REDACTED] K [REDACTED], I [REDACTED] S [REDACTED], Sh [REDACTED] I [REDACTED], Q [REDACTED] K [REDACTED], N [REDACTED] Sh [REDACTED], Xh [REDACTED] K [REDACTED], D [REDACTED] G [REDACTED], D [REDACTED] S [REDACTED], S [REDACTED] N [REDACTED], R [REDACTED] J [REDACTED], B [REDACTED] F [REDACTED], T [REDACTED] D [REDACTED], T [REDACTED] R [REDACTED], N [REDACTED] S [REDACTED], A [REDACTED] P [REDACTED], Z [REDACTED] J [REDACTED].

Në bazë të Nenit 333, paragrafi 2, Gjykata vendosi me pëlqimin e palëve që deklaratat e dëshmitarve në vijim, të dhëna në statet e mëparshme të procedurave të mirren parasysh dhe të futen në proces-verbalin e lëndës: B [REDACTED] H [REDACTED], F [REDACTED] Sh [REDACTED].

Gjykata pranoi në provat një numër dokumentash që përfshijnë Rregulloren e Punëve të Brëndëshme gjatë gjëndjes së Luftës (Beograd, 7 Prill 1999), si dhe dokumentat e cituara në proces-verbalin e gjykimit të datës 30 Prill 2003, faqja 2. Me këtë rast duke parë me kujdes këto dokumenta Gjykata konkludoi se ato nuk u përgjigjen pyetjeve kritike të

kësaj çështje, pikërisht se kush në fakt i kreu mënyrat të cilat Gjykata i gjeti se janë kryer në komunën e Kamenicës gjatë periudhës së Luftës, dhe së dyti nën kontrollin e kujt vepronin ata persona. Ndërsa është e qartë se kompetencat e Ministrisë së Punëve të Brëndëshme u rritën në kohë lufte, kjo nuk do të thotë se i pandehuri ishte personi, i cili urdhëroj që ato mënyra të kryheshin në komunë.

Më 7 Mars 2003, Gjykata kreu një kqyrje vizive të vën-ngjarjes së incidentit mbi të cilin janë bazuar dy akuzat e vrasjes në tentativë. Përveç anëtarve të kolegjit ishin gjithashtu të pranishëm edhe avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic, i pandehuri, si dhe dëshmitarët A ■ P ■ ■ ■, M ■ ■ ■ F ■ ■ ■ e Xh ■ ■ ■ K ■ ■ ■.

Duke shpjeguar arsyet e tija për aktgjykimin, Gjykata fillimisht do të mirret me akuzën e Krimeve të Luftës kundër popullsisë civile, më pas me supozimet e dy vrasjeve në tentativë dhe në fund me akuzën e armëmbajtjes pa leje.

Krimet e Luftës kundër popullsisë civile.

Aktakuza e amenduar e Prokurores Publike Ndërkombëtare e datës 26 Shkurt 2003, i ndanë çështjet faktuale në lidhje me këtë akuzë në një seri prej njëmbëdhjetë akuzash të ndara.

Aktakuza më tej supozon se gjatë periudhës kur ngjarjet kanë ndodhur, të gjitha kushtet e domozdoshme ishin të pranishme për secilin veprim për tu kualifikuar si akt penal i Krimeve të Luftës, kështu që gjatë gjithë kohës që përbën objekt të aktakuzës:

Në territorin e Kosovës egzistonte gjendja e konfliktit të brendshëm të armatosur midis UÇK-së ose Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të armatosura dhe ato të sigurimit të Republikës Federative të Jugosllavisë, duke përfshirë Ushtrinë Jugosllave (VJ), si dhe ato të Republikës Sërbe duke përfshirë forcat e Ministrisë së Punëve të Brëndëshme Serbe dhe grupet paraushtarake Serbe, si dhe një konflikt i armatosur ndërkombëtar bashkë-egzistonte me konfliktin e brendshëm të armatosur gjatë periudhës 24 Mars deri më 12 Qershor 1999;

Të dy forcat e armatosura ishin nën urdhrat e komandave përgjegjëse, ushtronin kontroll mbi pjesë të territorit të Kosovës, që i mundësonte ato të kryenin operacione ushtarake të mbështetura e të planifikuara;

Të gjitha viktimat ishin anëtarë shprehimisht të mbrojtur të popullsisë civile;

Një lidhje ekzistonte midis akteve të kryera nga i akuzuari dhe konfliktit të armatosur të brendshëm dhe të jashtëm. Ekzistenca e konfliktit të armatosur luajti një rol thelbësor në aftësinë e të akzuarit për ti kryer veprat penale, si dhe veprimet e të akzuarit ishin të lidhura direkt me konfliktin e armatosur;

Veprimet e të akzuarit u kryen në emër dhe ishin shumë të lidhura ngushtë me forcat e armatosura të Republikës së Sërbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë, palë në konflikt me UÇK-në e cila e deklaroi vetveten një ushtri të ligjshme më 15 ose më 16 Maj 1998.

Secili nga veprimet e lidhura me të ishin të shoqëruara prej qëllimit të domozdoshëm në mëndjen e kryerësit të tyre.

Sjellja e supozuar e të pandehurit u tha të ishte në kundërshtim me Nenin 142 të Ligjit Penal Jugosllav, sikurse ay lexohet me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të të njejtit, pikërisht kryerja, urdhërimi, veprimi në bashkëpunim me të tjerët, ndihmimi, pjesmarrja në një veprim të përbashkët penal, si dhe kryerja nga mospengimi, me qëllim të kryerjes së krimeve të luftës, si dhe që i pandehuri ishte kriminalisht i lidhur si personalisht po ashtu prej përgjegjesisë së tij komanduese.

Më tej sjellja e supozuar u tha se përfshin shkelje të ligjit të aplikueshëm ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Nenin 3 të Përgjithshëm të Konventës së katërt të Gjenevës të vitit 1949, ligjet ndërkombëtare të zakonëshme sikundër ato aplikohen në konfliktet e armatosura të brëndëshme dhe ndërkombëtare, Konventat e Hagës të viteve 1899 dhe 1907, Konventa e katërt e Gjenevës e vitit 1949, Protokollin I shtesë i vitit 1977 i Konventës së Gjenevës të 1949 sikundër ai aplikohet në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, si dhe Protokollin II shtesë i vitit 1977 i Konventës së Gjenevës të vitit 1949, sikundër ai aplikohet në konfliktet e brëndëshme ta armatosura.

Dispozita ligjore relevante.

Dispozitat e Nenit 142¹ të LPJ përcaktojnë që një person do të kryejë një veprë penale nëse ai/ajo urdhërohet ose kryen një akt të përcaktuar dhe se një akt ose urdhër i tillë është gjithashtu një shkelje e rregullave të ligjeve ndërkombëtare efektive në kohën e urdhërimit ose kryerjes. Kështu që urdhëri ose sjellja duhet të kalojë një test të dyfishtë: si gjëndja e aplikueshme po ashtu edhe ligji ndërkombëtar duhet të dënojë ngjarjen, në mënyrë që të aplikohet përgjegjësia penale.

Me qëllim që të përcaktohet përgjegjësia penale nën ligjet ndërkombëtare për çdo të akuzuar për Krime Luftë, Gjykata duhet të plotsojë çështjet e mëposhtme:

- a. Ekzistencën e një konflikti të armatosur, qoftë i brëndshëm ose ndërkombëtar, si dhe pjesmarrjen e të akuzuarit në konfliktin e armatosur;
- b. Një lidhje midis krimit të supozuar dhe konfliktit të armatosur;
- c. Statusi "civil" i viktimës;
- d. Që udhëri i të sjellurit në lidhje me shkeljen e ligjeve ndërkombëtare të jetë në fuqi në atë kohë;

¹ "Kushdo që shkel rregullat e ligjeve ndërkombëtare efektive në kohën e luftës, të konfliktit të armatosur ose pushtimit, e urdhëron që popullsia civile të bëhet subjekt i vrasjes, torturës, trajtimit jo njerëzor, eksperimentimeve biologjike, vuajtjeve të mëdha ose dhunimit të integritetit trupor ose shëndetit, shpërnguljen ose çvendosjen ose konvertimin e dhunshëm në një tjetër kombësi ose besim fetar; prostituimin e detyrueshëm ose përdhunimin; aplikimin e masave të frigimit dhe terrorit, marjen peng, caktimin e dënimeve kolektive, sjedhjen e paligjësme në kampet e përqëndrimit ose të tjera arrestime dhe mbajtje të paligjësme, mohimin e të drejtave të një gjykimi të drejtë; shërbimin e dhunshëm në ushtrinë armike ose në shërbimin e saj të zbulimit ose në administratë; punën e detyrueshme; vuajtjen nga uriya të popullsisë; konfiskimin e pasurisë, plaçkitjen, shkatërimin e paligjshëm dhe të vetë-dijshëm si dhe vjedhjen në një shkallë të madhe të pasurisë, që nuk justifikohet nga nevojat ushtarake, marrjen e një kontributi të paligjshëm dhe jo proporcional ose sekuestrimin, çvlerësimin e monedhës vëndase ose lëshimin e paligjshëm të monedhave, ose kush kryen një ose disa nga këto vepra duhet të ndëshkohet me burgim për një periudhë jo më pak se pesë vjetësh ose njëzet vjetësh burgimi"...

- e. Që urdhëri i të sjellurit të bjerë brënda atyre veprave penale të idendifikuara si krime lufte në Nenin 142;
- f. Pjesmarrja e të akuzuarit në veprën penale.

Jo të gjitha rregullat e ligjeve ndërkombëtare të aplikueshme në konfliktin e armatosur ndërkombëtar aplikohen në konfliktet e brëndëshme të armatosura. Në konfliktet e brëndëshme të armatosura elementët thelbësorë që përbëjnë termin “konflikt i armatosur” janë: (1) që përplasja e dhunëshme e armatosur të ndodhë midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura ose midis këtyre vetë grupeve brënda të njejtit Shtet, (2) se këto grupe në komandën e përgjegjshme, të ushtrojnë një kontroll të tillë mbi pjesë të territorit të Shtetit, në mënyrë të tillë që ti bëjnë ato të ndërmarrin operacione të rëndësishme dhe të organizuara ushtarake si dhe të implementojnë Protokollin e II-të të Konventës së Gjenevës të Gushtit 1949, dhe (3) që veprimet e dhunëshme të ndodhin në një shkallë më të gjërë se ajo që mundet të quhet si turbullim ose tension i brëndëshëm, sikundër janë demonstrimet e dhunëshme, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës si dhe akte të tjera të një natyre të ngjashme me to.²

Konflikti i Armatosur.

Që një konflikt i armatosur i përcaktuar si i tillë, ka egzistuar në Kosovë për një periudhë midis 1998 dhe 1999 nuk ka dyshim dhe nuk është hedhur poshtë nga asnjë provë ose argument i dëgjuar prej kolegjit, si dhe deklaratat e të pandehurit e mbështesin këtë përfundim. Kolegji i gjykimit i referohet çështjes së P v Vuckovic, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, aktgjykimi i datës 25 Tetor 2002, dhe bie dakord me përfundimet e shprehura në të në lidhje me ekzistencën e një konflikti të brëndshëm të armatosur, që ka bashkë-ekzistuar gjatë periudhës të cilën e mbulon kjo aktakuzë në të njejtën kohë me konfliktin e armatosur ndërkombëtar gjatë të njetës periudhë të ndërhyrjes së NATO-s, dhe si i tillë më së paku gjatë periudhës 24 Mars 1999 deri më 10 Qershor 1999.

Lidhja.

Të gjitha veprimet e supozuara në aktakuzë janë thënë të kenë nga natyra e tyre bazë, një lidhje me konfliktin e armatosur, që duhet thënë³ se kanë një lidhje të ngushtë ose lidhje me konfliktin e armatosur. Mbi bazën e gjykimit të provave, kolegji ndihet i sigurtë se një lidhje e mjaftueshme është përcaktuar midis veprimeve të supozuara, dhe të cilat kolegji gjyqësor i gjen të provuara, si dhe konfliktit të armatosur. Kishte sipas mendimit të kolegjit gjyqësor një pamundësi në kuptimin e ngjarjeve rreth të cilave folën shumë dëshmitarë, megjithse këto ngjarje janë të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur.

² Shih Protokollin e II-të të Gjenevës të 12 Gushtit 1949; P v Tadic, Apel mbi Juridiksionin e Gjykimit, Çështja No. IT – 94 – 1- A73.1, Dhoma e Apelit, 2 Tetor 1995, paragrafi 70; P v Akeyesu, Gjykim gjyqësor, Çështja No. ICTR – 96 – 4 – T, Dhoma e Gjykimit 1,2 Shtator 1998, paragrafi 620 dhe 625, si dhe Shih Komentaret e ICRC/KniKK mbi Protokollin e II-të.

³ Shih Gjykimin e AC *Kunarac* të ICTY/GjNKLLishJ, paragrafi 55 (“të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur”); Vendimi i juridiksionit mbi AC *Tadic* i ICTY/GjNKLLishJ (1995), paragrafi 70 (“te lidhura ngushtësisht me veprimete e dhunëshme”); Gjykimi i TC *Kunarac* prej ICTY/GjNKLLishJ, paragrafet 402 dhe 407 (“një lidhje e ngushtë”), Gjykimi i TC *Delalic* prej ICTY/GjNKLLishJ, 16 Nëntor 1998, paragrafi 193 (“një lidhje e qartë”), dhe në të njejtin, paragrafi 197 (“një lidhje e qartë”).

Statusi i "civilit" të viktimave.

Megjithse mbrojtja nuk e ceku këtë çështje, nuk ka patur prova për të treguar që ndokush prej viktimave ka qënë një person i cili ka marë pjesë aktive në veprimet e dhunëshme.

Urdhëri ose të sjellurit i të përfolurit ishte në shkelje të ligjeve ndërkombëtare efektive në kohën e kësaj sjellje.

Sjellja e shfaqur në këtë rast përfshin rrahje të rënda, trajtime jo njerëzore, tortura, përzënie e dhunëshme, dhe shkatërimin e pasurisë në një shkallë të madhe, të pajustificuar prej nevojave ushtarake, si dhe vrasjen. Shumica e këtyre tipeve të sjedhjes janë një shkelje e qartë e dispozitave të Ligjit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës, dhe Protokollit II të vitit 1977, si dhe më tej përcaktohen si të mjafta për tu ndjekur penalisht prej mbi bazën e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Ndërsa Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale nuk është përcaktues për ligjet ndërkombëtar pre-ekzistuese ose ato në zbatim, fakti i përfshirjes në ndalimet e saj është një tregues i rëndësishëm se sjedhja e përshkruar, ishte tashmë mirë e përcaktuar si në kundërshtim me nenet e ligjeve ndërkombëtare të kohës kur Statusi hyri në fuqi. Kolegji gjyqësor gjeti se çdo incident i përcaktuar, përfshin së paku një shkallë sjedhje e cila është një shkelje e qartë e këtyre dispozitave. Në përputhje me këtë, kolegji gjyqësor është i kënaqur me atë që sjedhja e provuar ishte një shkelje e ligjeve ndërkombëtare të aplikueshëm në kohën e ngjarjeve.

Përsa i përket përgjegjësisë komanduese, jurisprudenca e ICTY/GjNKLIshJ përcakton se shkelja e ligjeve humanitare të konfliktit të brëndëshëm të armatosur ngjitet në vetë krimet e luftës, si rezultat i evolucionit të ligjeve të zakonëshme në komunitetin ndërkombëtar me një kalim racional dhe gradual prej një përqsaje të Shtetit-të orientuar-Sovran në një të të orientuar-njerëzisht. Duke vijuar këtë arsyetim është e logjikëshme të pranohet që i njëjti proces gradualisht të shpije në një pranim të principit të përgjegjësisë komanduese në pikën që tashmë është përcaktuar si një ligj i zakonshëm i ligjeve ndërkombëtare si në konfliktet e armatosuara të brëndëshme po ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Përgjegjësija komanduese është pivotuese në lidhje me çdo njësit ushtarak të angazhuar në çdo formë të konfliktit: a) për të siguruar disiplinën dhe përputhjen me ligjet kombëtare dhe ligjet humanitare ndërkombëtare, dhe b) me qëllim për të mbrojtur civilët dhe qëniet njerzore kundër abuzimeve dhe vuajtjeve të panevojshme. Asnjë arsye e besueshme nuk mundet të mbështesë një ndryshim në përqsaje përsa i përket përgjegjësisë penale në këtë fushë të bazuar në asgjë më shumë se në atë, që konflikti duhet vlersuar si i brëndshëm ose i ndërkombëtar në karakterin e tij – një faktor që është plotësisht irrelevant në kuptimin humanitar të tij. Përgjegjësia komanduese në konfliktin e brëndshëm të armatosur është gjithashtu një pasojë natyrore e principit të përgjegjësisë komanduese të përfshirë në Nenin 1 të Protokollit II të Gjenevës të vitit 1977, sikundër shpjegohet në vendimin e Apelit të *Hadzihasanovic*⁴ mbi Juridiksionin, ku gjykata qartazi deklaroj se "detyrat e përfshira në përgjegjësinë

⁴ Shih më sipër në shënimin Nr. 3.

komanduese janë përgjithsisht të përforcuara përmes përgjegjesisë komanduese, dhe këto të fundit rrjedhin nga të mëparshmet”.

Urdhëri për veprim duhet të jetë në kundërshtim me Nenin 142 të LPJ.

Nuk ka dyshim se të gjitha çështjet e supozuara në këtë aktakuzë, nuk janë provuar më pas të jenë në shkelje të Nenit 142 të LPJ.

I pandehuri duhet provuar që të ketë marrë pjesë në veprën penale.

Ishte në këtë fushë çështja që më fortë u ngrit në këtë rast. Është një princip themelor në të dy ligjet penale, si atë vëndor po ashtu edhe në atë ndërkombëtar, se çdo person i akuzuar para se të dënohet për një vepër penale duhet të tregohet pjesmarrja e tij në këtë vepër me anë të mjeteve të ofruara prej ligjit. Nuk ka mister në lidhje me mënyrat e ndryshme me anë të të cilave një person mundet të marrë pjesë në një vepër penale. Mbi bazën e ligjit vëndor të Kosovës, pjesmarrja mundet të jetë direkte ose me anë të një udhe anësore në një nga momentet e identifikuar si tërheqëse të përgjegjesisë penale dhe të përcaktuara në Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të LPJ (bashkëpjesmarrja, ndihmesa, anëtar i një grupi ose pranimi i kryerjes). Përsa i përket qëllimeve të këtij aktgjykimi nuk ka ndryshime të rëndësishme midis ligjit vëndor të aplikueshëm dhe atij ndërkombëtar.

I pandehuri e pranoj se ai ishte anëtari më me pozitë në stafin e stacionit policor të Kamenicës gjatë periudhës në fjalë. Titulli i tij i saktë ishte ose “Drejtuës” i Policisë ose “Shef i Policisë”, por ndryshimi nuk ka ndonjë rëndësi reale. Si i tillë, shtysa kryesore çështjes nga akuza kundër tij ishte se ai nga përkufizimi ishte personi që duhej të ishte përgjegjës për tmerret që supozohet të kenë ndodhur në fshatra të ndryshëm brenda komunës së Kamenicës gjatë konfliktit të armatosur dhe në veçanti gjatë periudhës së ndërhyrjes së NATO-s. Akuza u drejtua nga një sasi e madhe deklaratash prej dëshmitarve në zonë, të cilët vetë vlersuan se i pandehuri duhet të jetë fajtor dhe supozuan se më së fundmi, edhe nëse nuk mundet të tregohet që i pandehuri ka dhënë urdhëra specifike të cilat rezultuan në krime, është përcaktuar se ai duhet ti ketë ditur ngjarjet e tmerrshme se ishte në një pozicion superior komandues dhe në gjëndje të ndëshkonte përgjegjësit, megjithatë ai nuk ndërmori asnjë hap për të bërë një gjë të tillë.

Në një analizë të kujdesëshme të këtij argumenti është megjithatë mendimi i kolegjit gjykues, se argumentat e akuzës si ato direkte po ashtu edhe ato indirekte si dhe përgjegjësija komanduese janë të pa logjikëshme. Kolegji gjykues për asryet e përmëndura më poshtë pati pak vështirsi në mbritjen e përfundimit, se shumica e ngjarjeve rreth të cilave dhanë deklaratave dëshmitarët kanë ndodhur thelbësisht sikurse ato përshkruhen. Ndërsa akuzat e dëshmitarve përfshinin shumë mos-përputhje, natyra bazë e ngjarjeve që ato përshkruajnë ishte sipas mendimit të kolegjit gjykues një përshkrim i saktë i fakteve që ato ose i kanë jetuar ose kanë dëgjuar rreth tyre shumë pak pas ndodhjes së tyre. Një fakt i rëndësishëm në këto tregime ishte ay që, nuk kishte një incident të vetëm gjatë gjithë deklaratave në të cilin ndonjë dëshmitar të supozojë që ai ose ajo të ketë parë të pandehurin në ose pranë vëndit të krimit në kohën kur ka ndodhur

ngjarja. Më tej, në lidhje me çdo rast të tillë kolegji është lënë në dyshim, që ajo deklaratë të ishte mjaftueshmërisht e besueshme për tu pranuar nga kolegji gjykues dhe për tu mbështetur në të.

Çështja e mbrojtjes ishte relativisht e thjeshtë. Në thelb i pandehuri supozoj se megjithse ai kishte titullin e Shefit të Policisë ose të ngjashëm më të, funksionet e degës së Kamenicës të Ministrisë së Punëve të Brëndëshme ("OUP"), ishin të ndara në pjesë puthuajse të veçanta, i pandehuri sqaroi se çështjet e policisë active ishin fushë e Komandantit të Policisë, ndërsa i pandehuri mirrej kryesisht me çështje administrative sikurse lëshimi i kartave të identitetit, lejeve të vozitjes dhe pashaportave. I pandehuri tha që ka patur pak mbivendosje midis të dy sektorëve të stacionit të policisë. Ndersa ne shikimin e pare nje shpjegim i tille mund te duket shume i pershtatshem, fakti eshte si kishte disa prova te besueshme per rastin per ta mbeshtetur ate dhe mungese te provave te besueshme alternative. Me tej, duhet te verehet se ndarje te ngjashme funksionale kane ndodhur edhe ne institucione te tjera ne ish Jugosllavi. Konstatimi i te pandehurit se ai dinte pak gjera per veprimet e policise se rregullt ne Kamenice pavaresisht se kishte nje shkalle dyshimi nuk u hodh poshte.

Nje veshtiresi e metejshme dhe ndoshta me themelore ka te beje me identitetin dhe origjinen e atyre personave qe kryen ato vepra penale. Gjykata ishte e interesuar gjate gjithë procedurës gjyqesore për të parë nëse ata që kishin kryer mizoritë të identifikoheshin me besim dhe nëse po atehere nëse do të mund të tregohej që ata të kishin ndonjë lidhje me të pandehurin. Ka pasur shumë raste kur forca të llojeve të ndryshme kanë marrë pjesë në operacione të përbashkëta; kjo karakteristike tregon nivelin e lartë të organizimit, shumë përmbi nivelin që ishte i punësuar i pandehuri, dhe me pasojë të qarta edhe për pretendimet mbi përgjegjësinë direkte edhe komanduese të drejtuar kundër tij. Në analizën e fundit gjykata gjeti se kjo veshtiresi nuk ishte kaluar në prova, dhe se në të vërtetë ngjarjet e tmerrshme që kanë ndodhur në komunën e Kamenicës gjatë periudhës së luftës, të cilat kanë qenë në kontrast të dallueshëm me modelin e përgjithshëm të ngjarjeve në periudhën menjëherë përpara, nuk janë nxitur, urdheruar dhe kryer nga i pandehuri, dhe fakti se ai mund të ketë pasur dijeni për të paktën disa prej tyre me vone nuk e ndryshon këtë përfundim.

Pas përmbledhjes së provave të të pandehurit, gjykata do të bëjë vlerësimin e provave të lidhura me sejcilën veprë veç e veç.

Tregimi i të pandehurit. I pandehuri ka deklaruar se në kohën për të cilën bëhet fjalë ai ka qenë shefi i "OUP" në Kamenicë. Si i tillë, ai ka qenë përgjegjës për çështjet administrative duke përfshirë dokumentat e udhëtimit, kartat e identifikimit, regjistrimet e makinave dhe aktivitetet ekonomike dhe të përgjithshme kriminale dhe në lidhje me këto detyra ai ka marrë urdhera nga shefi i "SUP"-it në Gjilan. Sipas të pandehurit ai nuk ka marrë pjesë në aktivitetet e policisë së uniformuar të stacionit të policisë së Kamenicës, të cilat janë drejtuar nga komandanti i policisë, Dragan Slavkovic.

I pandehuri ka deklaruar se ai nuk vishte uniforme zakonisht, dhe as që merrte pjesë në hetime në vendngjarje. Ai tha që nganjëherë shqiptaret vinin në zyrën e tij për të kërkuar

pasuese ai eshte qelluar ne aferi te shtepise se tij ne rrethinat e Kamenices nga nje polic nga Kamenica me emer Stankovic Sretko. Kolegji ka mundur te shohe provat fizike nje plage plumbi ne kemben e deshmitarit afer nyjes se kembes. Deshmitari deklaroi se ai kishte pasur problem me te pandehurin qe nga 1993 kur ai ishte arrestuar dhe denuar me 30 dite ne burg. Ndersa kishte qene ne paraburgim deshmitari tha se i pandehuri e kishte vizituar dhe e kishte ofenduar.

Per sa i perket incidentit te prillit 1999, deshmitari deklaroi se *"Une besoj se eshte bere nepermjet te akuzuarit sepse ai ka qene shefi dhe ai ka dhene urdhera, keshtu qe perfundimi im eshte se ai duhet te kete urdheruar, thjesht sepse ai ishte shefi i policise"*.

Duke pranuar se incidentit i gjuajtjes ka ndodhur sic eshte pershkruar nga deshmitari, edhe duke marre parasysh ngjarjen e meparshme ne vitin 1993, kolegji nuk mund te mbeshtese perfundimin e deshmitarit. Nuk ka asgje ne rrethanat e pershkruara qe te dergojne ne perfundimin se i pandehuri ka urdheruar qe te qellohej, ose qe ai te kete mesuar per kete me vone qe ta vinte ate para detyres qe te hetonte dhe denonte sic duhej. Prandaj, perseri, nuk eshte percaktuar se i pandehuri ka urdheruar ose ka marre pjese ne vepren penale ne cfaredo menyre.

Akuzat 4, 8, 9 dhe 11.

Kolegji nuk ka arritur te mbledhe asnje prove ne lidhje me ndonje nga keto vepra.

Akuza 5.

B [REDACTED] S [REDACTED]⁹ deklaroi se ne nje date gjate luftes (te cilen kolegji e pranon qe te kete lidhje me periudhen nga 24 mars 1999 deri me 10 qershor 1999), ndersa ka qene ne fshatin e saj Leshtar, ajo eshte qelluar dhe eshte plagosur me dy plumba, njeri prej te cileve eshte nxjerre, kurse tjetri ka mbetur ne trupin e saj. Deshmitarja deklaroi se edhe burri i saj ishte qelluar dhe te tjeret ne fshat ishin rrethuar dhe burrat ishin detyruar te shtriheshin ne dysheme, shtepia ishin djegur dhe ishte hapur zjarr dhe qelluar. Deshmitarja nuk mund te pershkruante rrobat e personave qe kishin sulmuar ate dhe fshataret e tjere, pervec se personat pergjegjes kishin veshur uniforma dhe flisnin serbisht, qe ajo nuk kuptonte asgje.

Deshmitarja deklaroi *"Une besoj se i pandehuri eshte fajtor per keto ngjarje, te gjitha ne kete zone e dine se i pandehuri eshte pergjegjes per zonen. Une e kam ditur se ai ka punuar ne Kamenice, por une nuk e kam ditur se cfare posti ka pasur"*.

B [REDACTED] H [REDACTED]¹⁰ gjithashtu nga fshati Leshtar, deklaroi se ne mengjesin e 18 prillit 1999 fshati eshte rrethuar nga *"paramilitare"*. Personat ne fjale i kane thene te dilnin jashte *"Kjo nuk eshte shqiptare eshte serbe"*. Pasi ishin nxjerre jashte nga shtepiat e tyre fshataret ka shkuar perpjete kodres ne nje livadh, ku pane se *"policia dhe ushtria"* i kishte rrethuar. Pastaj eshte hapur zjarr dhe nena e deshmitares (deshmitares se

⁹ PGJ 27.06.02

¹⁰ PGJ 18.07.02

ndihmen e tij per personat e humbur. Ai ka qene pergjegjes per sektorin administrativ te stacionit te policise, pavaresisht se ai ka pranuar qe ka qene me grade me te larte se komandanti i policise. I pandehuri njihej ne Kamenice si shef i policise, pavaresisht se nga deshmia e tij del se ky ishte me shume titull formal sesa pasqyrimi i punes se tij te perditshme. I pandehuri deklaroi se gjate periudhes se 24 marsit 1999 deri ne hyrjen e NATO-s ne Kosove me 10 qershor 1999 nuk ka pasur konflikt te armatosur ne zonen e Kamenices ne mes te serbeve dhe shqiptareve. Ai tha se ajo qe donte te thonte me kete verejtje ishte se nese police nga Kamenica kishin marre pjese ne ndonje nga akuzat e bera kunder tij ne aktakuze ai ishte i sigurt se do te kishte degjuar per ta ne ate kohe. Ai tha se punonjesit e tij kishin vazhduar te kryenin detyrat e tyre ne stacionin e policise deri me 17 qershor 1999.

I pandehuri konfirmoi se ai kishte nenshkruar disa urdhera per te marre me qera autobusa per te transportuar policet nga Kamenica ne zona te tjera te Kosoves gjate periudhes nga marsi deri ne maj 1999.

I pandehuri me tej tha se ai kishte degjuar per disa ngjarje te keqia ne rajonin e Kamenices gjate periudhes nga marsi deri ne qershor 1999 por nuk kishte marre raporte te detajuara per keto. Ai deklaroi se nuk ishte ne pozite te jepte urdhera per te parandaluar ngjarje te tilla qe te perseriteshin nese ishin ndermarre nga ushtria Jugosllave, meqenese ushtria nuk ishte nen kontrollin e policise.

I pandehuri pranoi se ne rast se nje veper do te kryhej nga nje vartes i tij ne stacionin e policise se Kamenices atehere ai do ta kishte per detyre per bente hetimet per ate ceshtje.

I pandehuri deklaroi se ishte normale qe policia te punonte jashte territorit te tyre normal gjate kohes se luftes.

I pandehuri pastaj shpjegoi historine e tij ne rajonin e Kamenices per shume vite, e cila perfshinte punen e tij si mesues dhe nga 1991/2 deri ne 1995 si shef i sigurimit kombetar, qe perfshinte trajtimin e ekstremizmit, terrorizmit dhe ceshtjeve te ngjashme.

Shkurtimisht, i pandehuri mohoi te kete marre pjese ne cfaredo kryerje te ndonje vepre te pretenduar ne aktakuzen kunder tij.

Akuza 1.

Eshmitari M [REDACTED] R [REDACTED]⁵ deklaroi se ndersa po qendronte ne deren e tij ne fshatin Mocare, komuna e Kamenices, me 1 prill 1999, ai eshte qelluar nga nje fqinje i tij, D [REDACTED] T [REDACTED], dhe ai ishte plagosur ne shpatull. Ky deshmitar deklaroi "Une besoj se ai (i pandehuri) ka dhene urdher qe une te qellohesha per shkak te postit te tij si shef policie". Me vone ne deshmine e tij deshmitari shtoi se ai e besonte se ishte keshtu ngaqe personi qe e kishte qelluar kishte thene se po e bente kete me urdher te te pandehurit.

Nuk kishte asnje prove tjeter per te mbeshtetur kete veper.

⁵ Procesverbali I Gjykimit (PGJ), 26.06.02

Sipas mendimit te kolegjit te gjykates, kjo deshmi eshte komplet e pamjaftueshme per denim. Duke pranuar qe incidenti te kete ndodhur, dhe se autori i krimit te kete deklaruar se po e kryente vepren me urdher te te pandehurit, kolegji nuk mund te jete i sigurt ne asnje menyre se kjo deklarate paraqet fakte te verteta. Prandaj, nuk eshte percaktuar qe i pandehuri te kete dhene urdher apo te kete marre pjese ne ndonej veper ne cfaredo menyre.

Akuza 2.

F [redacted] Sh [redacted]⁶ ka dhene deshmi se ajo ka qene ne shtepine e saj ne Kamenice ne nje date qe nuk eshte specifikuar, por e cila ne baze te pretendimeve qe jane bere gjate gjykimit, kolegji ka arritur ne perfundimin se ka qene brenda periudhes se konfliktit te armatosur mes NATO-s dhe RFSJ dhe forcave Serbe. Me ate rast deshmitarja deklaroi se e kishte pare te pandehurin ne shtepine e familjes se saj dhe se ai kishte kerkuar celesin e nderteses se shkolles per ngarjen e makines, i cili ishte biznesi i familjes. Me vone, gjate mbremjes shkolla per ngarjen e makines dhe shtepia e familjes ishin djegur. Pavaresisht se deshmitarja deklaroi se kishte frike nga i pandehuri ajo nuk ka mundur te jape me shume detaje rreth asaj cfare kishte thene ose bere ai.

Nuk kishte prova te tjera per te mbeshtetur kete veper., pervec deklarates se motres se deshmitares, F [redacted] Sh [redacted]⁷, e cila eshte lexuar per shkak se ajo ishte ne Zvicer dhe me pajtimin e paleve. Ajop deshmitare ka deklaruar se i pandehuri kishte vizituar shtepine e familjes se saj dhe kishte kercenuar biznesin e familjes dhe se autobusi do te digjen naten. Ky kolegji i gjykates konsideron se deklarata e kesaj deshmitareje e dhene ne gjykimin e meparshem nuk eshte as e detajuar ne menyre te mjaftueshme dhe as nuk ka nje lidhje logjike qe te mbeshtetemi kunder te pandehurit. Vecanerisht, Kryetari i Kolegjit ka bere gabim qe ka nderprere mbrojtjen gjate eksplorimit te mosperputhjeve qe ekzistonin mes asaj qe i kishte thene deshmitarja kolegjit ne krahasim me ate qe i kishte thene gjykatesit hetues.

Perseri, sipas mendimit te kolegjit kjo deshmi ishte e pamjaftueshme per denim. Ndersa e pranojme faktin se i pandehuri ka vizituar shtepine e familjes sic pretendohet nga deshmitaret, dhe se ambjentet e biznesit dhe shtepia jane djegur me vone ne te njejten dite, sugjerimi se i pandehuri eshte fajtor per kete do te ishte spekulim; perseri, nuk eshte vertetuar se i pandehuri ka urdheruar ose ka marre pjese ne vepren penale ne cfaredo menyre.

Akuza 3.

Xh [redacted] L [redacted]⁸ ka deklaruar se me 17 prill 1999 ai eshte ndaluar nga policia dhe eshte urdheruar t'ia dorezonte makinen e tij policise. Pervec kesaj edhe nje numer dokumentash qe i perkisnin djalit te tij dhe atij vete i jane marre. Ose ate dite, ose ditën

⁶ PGJ 18.07.02

⁷ PGJ 06.03.03

⁸ PGJ 27.06.02

meparshme) eshte plagosur. Deshmitarja i ka pershkruar sulmuesit te kene perfshire paramilitare dhe personel te policise.

Deshmitarja deklaroi, kuptohet sipas mendimit te kolegjit, se ne ditën kritike ajo nuk ka njohur asnjëri meqenese ka qene shume e frikesuar, vecanerisht duke qene se nena e saj ishte plagosur, dhe per me teper, sulmuesit kishin pasur maska ne fytyrat e tyre. Deshmitarja deklaroi se forcat pushtuese kishin ardhur me kamiona. Deshmitarja deklaroi se kater te aferm te saj i kishin thene asaj se ishin derguar ne Kopenice, ne rajonin e Kamenices pasi ishin mbajtur ate dite ne fshat.

Kolegji nuk pati veshtiresi te arrinte ne perfundimin se me date 18 prill 1999 fshati Leshtar i komunes se Kamenices ishte rrethuar nga forcat Serbe dhe/ose Jugosllave duke perfhsire ushtrine, paramilitare dhe forca policore, dhe se fshataret ishin nxjerre jashte nga shtepite e tyre, shtepiat ishin djegur, ishte hapur zjarr mjaft, dhe Bahtije Sinani ishte qelluar dhe plagosur.

Megjithate, nuk ka prova se ndonje nga forcat e policise qe merrnin pjese e kishin bazen ne stacionin e policise se Kamenices. Kolegji pranon deshmine e te pandehurit se gjate kohes se luftes personeli i policise nuk ishin te kufizuar ne territorine tyre te caktuar dhe per me teper ne cfaredo kohe ata mund te ishin nen drejtimin e ushtrise. Ne kete pike nuk ka asnje prove qe ndonje nga aktivitetet e tmerrshme qe kane ndodhur ne fshat te jene urdheruar nga i pandehuri ose te jene kryer me dijenine apo aprovimin e tij. Sipas mendimit te kolegjit perfshirja e te pandehurit ne formen e urdherimit te ketyre ngjarjeve nuk eshte perfundim i paevitueshem nga faktet. Per me teper, nuk ka asnje prove qe tregon se i pandehuri eshte vene ne dijeni te ketyre ngjarjeve gjate periudhes se luftes, dhe edhe nese eshte vene ne dijeni, nuk eshte percaktuar qe ne ate kohe ai ka pasur mundesi te caktonte hetimet dhe/ose denimin mbi autoret e krimit. Prandaj, ndersa ngjarjet jane konstatuar ne vetvete fajesia e te pandehurit mbetet e paprovuar.

Akuza 6.

Kjo veper ka lidhje me ngjarje te tjera te dates 18 prill 1999. B. ■■■ K. ■■■¹¹ deklaroi se me 18 prill 1999 ai ka qene duke kaluar neper fshatin Rahovice me dy persona kur tre police kane dale nga makina; ata kane pasur te veshur uniforma me lara te kalterta te policise. Deshmitari ka arritur te fshihet dhe pastaj ka pare te afermit e tij te ndiqeshin nga policet. Ai ka pare kusheririn e tij R. ■■■, te konfrontohej nga njeri prej policeve dhe R. ■■■ i ka pasur duart e ngritura lart. R. ■■■ nuk eshte pare me dhe disa muaj me vone pjese te mbetjeve te tija, duke perfshire xhaketen e tij jane gjetur ne stadiumin e futbollit ne Kamenice. I afermi tjetër, I. ■■■, ka mbijetuar dhe tani jeton ne Prishtine.

Deshmitari deklaroi se familja kishte degjuar se R. ■■■ ishte vrare ne rrugen per ne Strezovc, dhe se procesverbali i gjykimit te meparshem, ku ishte shenuar se deshmitari kishte thene se R. ■■■ ishte vrare ne stacionin e policise ne Kamenice ishte i jo i sakte.

¹¹ PGJ 18.07.02

Deshmitari deklaroi se pavaresisht se ai e kishte pare te pandehurin me police te tjere ne fshatra ne 1998 ai nuk e kishte pare ne keto rrethana ne 1999, duke thene se nerezit frikesoheshin te dilnin jashte. Megjithate, shenimet e gjykates se incidenti qe deshmitari i ka pershkruar gjykates per daten 18 prill 1999 kane ndodhur ndersa deshmitari dhe te afermit e tij nuk kane qene ne shtepite e tyre.

Se fundi, deshmitari konfirmoi se kur ai kishte thene me pare se dy persona ne fshatin e tij ishin vrare me urdher te te pandehurit "...ky eshte perfundimi im meqenese ai eshte shefi i policise".

N [REDACTED] V [REDACTED]¹² deklaroi se me 18 prill 1999 ajo ka qene ne shtepine e nenes se saj ne Rahovice. Kjo deshmitare pershkroi se si forcat sulmuese me uniforma te gjelbra i kane nxjerre nerezit me force nga shtepiat e tyre. Deshmitarja deklaroi se ajo i njihte disa nga personat nga Kamenica por ne te njejten kohe nuk ishte e qarte nese ata kane qene ushtri, paramilitare apo police. Deshmitarja pershkroi shume raste te keqtrajtimit te rende dhe grabitjesh ne fshatra, dhe vrasjen e vellaits te saj Sh [REDACTED] I [REDACTED]. Deshmitarja ne nje rast tha se burrat ishin detyruar te shtriheshin per toke dhe sulmuesit filluan t'i vrisnin ata aty. Me vone ajo e ndryshoi kete duke thene se sulmuesit tentuan t'i vrisnin burrat ne ate vend.

Deshmitarja identifikoi nje polic "Zhivojin", te njohur gjithashtu si "Persa", dhe deklaroi se ajo kishte pare tre police te tjere nga stacioni i policise se Kamenices, "Bora, Sasha dhe Zoran", dhe se kishte apsur te tjere te cilet ajo i kishte njohur nga pamja.

Deshmitarja deklaroi se besonte qe i pandehuri te kishte dhene urdher per ngjarjet meqenese ai ishte pergjegjes per stacionin e policise. Se fundi u be e qarte se kjo deshmitare po thoshte se kishte qene nje operacion i perbashket i policise, ushtrise dhe paramilitareve.

T [REDACTED] I [REDACTED]¹³ deklaroi se me 18 prill 1999 ajo kishte qene me familjen e saj ne Rahovice. Ajo tha se atje kishte ushtri dhe forca paramilitare, por nuk pershkroi personel te policise ose persona te veshur me uniforma te policise te kene qene prezent. Ajo konfirmoi natyren esenciale te incidentit dhe pershkroi se burri i saj ishte marre, kishte degjuar krisma, dhe me vone kishte gjetur trupin e tij.

Ajo deklaroi se besonte qe i pandehuri ishte pergjegjes, pavaresisht se nuk mund te ofronte arsye per te mbeshtetur mendimin e saj. Kjo deshmitare kuptohej qe ishte shume e nervozuar kur jepte deshmine e saj.

K [REDACTED] I [REDACTED]¹⁴ deklaroi se kishte qene ne shtepine e tij ne Rahovice me 18 prill 1999 dhe se fshati ishte rrethuar nga forcat e mbrojtjes territoriale, persona me uniforma te policise, persona qe kishin veshur uniforma me lara te ushtrise dhe paramilitare, te gjitha te stacionuar si nje formacion ne forme patkoi ne mengjes heret. Deshmitari pershkroi keqtrajtimet qe i ishin bere atij dhe te tjereve dhe menyren se si ishin detyruar fshataret te

¹² PGJ 28.06.02

¹³ PGJ 28.06.02

¹⁴ PGJ 28.06.02

largoheshin nga fshati. Ai kishte pare vellain e tij Sh [redacted] te merrej ne nje oborr dhe kishte degjuar krisma, dhe me pas kishte pare tymin te ngrihej. Deshmitari deklaroi se kishte pare tre police nga stacioni i policise se Kamenices dhe i tha emrat e tyre si "Persa", "S [redacted] M [redacted]" dhe "M [redacted] B [redacted] V [redacted]". Deshmitari dha deshmi kontradiktore ne lidhje me faktin nese kishte pare nje person me emrin "N [redacted] B [redacted] S [redacted]" te merrte pjese ne ngjarje.

Perseri, kolegji konstatoi se ngjarjet kane ndodhur sic i kane pershkruar deshmitaret. Eshte e qarte se me 18 prill eshte zhvilluar nje operacion i gjere kunder fshatit Rahovice por nuk eshte e qarte nen komanden e kujt kane qene forcat e ndryshme, pavaresisht se lloji i operacioni sugjeron qarte se duhet te kete qene nje komadant i pergjithshem. Nuk eshte vertetuar ne asnje menyre qe i pandehuri ka qene ai komadant ose qe ai te kete pasur pushtet ne ndonje fare menyre per te ndaluar qe ngjarjet te mos ndodhnin. Gjykata pranon qe disa police nga Kamenica kane qene te perfshire ne ngjarje por kjo nuk verteton qe i pandehuri ka urdheruar apo ka lejuar pjesemarrjen e tyre. Prandaj, gjykata arrin ne perfundimin se pjesemarrja e te akuzuarit, qofte duke urdheruar qe ngjarjet te zhvillohen apo me pjesemarrje aktuale ne nje forme apo nje tjeter te parapare me ligj, eshte percaktuar.

Akuza 7.

L [redacted] L [redacted]¹⁵ nga fshati Petrovc deklaroi se ne mengjesin e dates 19 prill 1999 forca policore dhe ushtarake kane rrethuar fshatin. Se bashku me familjen e tij ai eshte pergatitur te largohet por xhaxhai i tij dhe kusheriri, M [redacted] Sh [redacted] dhe F [redacted] Sh [redacted] kane refuzuar te shkojne. Kur ata jane larguar nga fshati ne nje kolone njerezish ata kane degjuar krismat ne fshat dhe kane pare tymin. Me vone atyre u eshte grabitur ari dhe gjerat me vlere dhe u kane thene te shkojne ne Maqedoni. Personat pergjegjes kane qene ushtarake, paramilitare dhe forca policore. Ai ka njohur nje person, A [redacted] V [redacted]. Fshataret jane detyruar te qendrojne ne fshatin Sllatine per 28 dite dhe jane kthyer ne shtepiat e tyre pas luftes. Ai nuk i ka pare me xhaxhain dhe kusheririn e tij. Deshmitari drejtesisht tha se nuk mund te thoshte se kush ka qene duke komanduar forcat, por shtoi se pavaresisht se nuk kishte pasur kurre problem me te pandehurin "*askush ne polici nuk mund te kishte bere gje pa lejen e tij*". Gjithsej 37 shtepia dhe 10 dengje me sane jane djegur ne Petrovc.

Per sa i perket ketij deshmitari, i pandehuri deklaroi se ne kohen per te cilen behet fjale ushtria ka qene pergjegjese per zonen ku pretendohet te kene ndodhur keto ngjarje.

B [redacted] K [redacted]¹⁶ deklaroi se me 19 prill 1999 edhe ai kishte qene ne shtepine e tij ne Petrovc. Ai kishte folur me V [redacted] A [redacted], i cili ishte shefi per mbrojtjen civile dhe A [redacted] kishte konfirmuar se te gjithe fshataret duhet te largoheshin deri ne oren 11:00 paradite. Fshati ishte rrethuar dhe te gjithe jane detyruar te largoheshin. Deshmitari konfirmoi tregimin e L [redacted] L [redacted] per faktin se ushtria, forcat paramilitare dhe policore kane vepruar

¹⁵ PGJ 22.07.02

¹⁶ PGJ 22.07.02

kunder fshatareve dhe se fshataret ishin trajtuar ne menyre shume agresive dhe armiqesore. Shume persona nga fshati jane grabitur dhe keqtrajtuar.

Deshmitari deklaroi se policia e kishte intervistuar ate te pakten 10 here. Ai pershkroi stilet e ndryshme te unifomave te ushtrise, paramilitareve dhe personelit te policise. Deshmitari deklaroi, "Policet qe rrethuan fshatin tone besoj se kane qene nga Kamenica, por une nuk kam njohur ndonjerin prej tyre". Deshmitari nuk ishte ne gjendje te jepte ndonje arsye per kete qe besonte.

Kolegji e pranon se me 19 prill 1999 fshataret nga Petrovci jane nxjerre jashte nga fshati nga nje kombinim i forcave Serbe dhe te RFSJ-se te perbere nga ushtria, paramilitaret dhe personeli i policise. Per me teper, ka prova te forta faktike ne mbeshtetje te faktit se ata qe nuk jane larguar jane vrare, dhe duke pasur parasysh kete fakt kolegji ka arritur ne perfundimin se ata qe kane sulmuar fshatin kane vrare F [redacted] dhe M [redacted] Sh [redacted].

Edhe nje here, megjithate, asnje lidhje nuk eshte percaktuar mes ketyre ngjarjeve dhe te pandehurit. Thjesht nuk eshte e mjaftueshme per te konstatuar se vetem sepse keto ngjarje kane ndodhur ne komunen e Kamenices i pandehuri duhet te mbahet pergjegjes ne nje menyre apo nje tjetër. Kjo mund te tregohet duke iu referuar faktit se eshte e pamundur t'i vishet ndonje forme te vecante te pergjegjesise penale te pandehurit per keto vepra: edhe duke supozuar, sic jane munduar shume deshmitare te bindin kolegjin te pranoje, se i pandehuri ka qene fajtor ne nje fare menyre, nuk ka fakte te konstatuara qe do te mundesonin qe kolegji te identifikonte kualifikimin specifik per kete pergjegjesi. Ne keto rrethana kolegji nuk mund te arrije ne perfundimin se fajesia eshte vertetuar.

Akuza 10.

Nje numer i konsiderueshem i deshmitareve kane dhene deshmi ne lidhje me pretendimet e parashtruara ne akuzen 10. Kolegji nuk ka dyshim se me 11 maj 1999 kane ndodhur nje numer i konsiderueshem incidentesh te renda ne fshatra te ndryshme te komunes se Kamenices. Ceshtja ne kete rast ishte nese kishte prova te besueshme per te treguar se i pandehuri ishte i perfshire penalisht ne ndonje nga keto incidente.

F [redacted] Th [redacted]⁷ deklaroi se me 11 maj 1999 fshati Karaqeve eshte rrethuar nga forcat policore. Disa nga sulmuesit kane hyre ne shtepine e saj dhe kane marre burrin e saj, A [redacted] Th [redacted] dhe vjehrrin e saj jashte. Vjehrrin e saj eshte keqtrajtuar kurse burri i saj ishte marre me vete; ajo nuk e pa me burrin e saj te gjalle. Dy muaj a gjysem me vone trupi i burrit te saj eshte gjetur ne nje liqen. Deshmitarja nuk kishte njohur asnje nga burrat qe kane sulmuar fshatin e saj pavaresisht se ajo i pershkroi ato si police. Deshmitarja tha gjithashtu per te pandehurin "askush ne polici nuk mund te vepronte pa urdherin e tij".

Kjo deshmitare deklaroi se pese persona te tjere nga fshati ishin marre, duke perfshire M [redacted] S [redacted], R [redacted] L [redacted], I [redacted] I [redacted] dhe N [redacted] R [redacted] dhe ditën tjetër fshataret kane degjuar se te gjithë ata ishin vrare.

¹⁷ PGJ 23.07.02

H [redacted] Th [redacted]¹⁸ konfirmoi detajet e sulmit ne fshatin Karaqeve. Ai deklaroi se ushtria dhe forcat policore sulmuan fshatin dhe se forcat policore hyne ne shtepi duke kerkuar djalin e tij, A [redacted]. Nje nga ata qe kishin qene prezent ishte D [redacted] S [redacted], komandant policie dhe shok i te pandehurit. S [redacted] kishte nje cope leter me vete. Dëshmitari deklaroi se dy nga policet e tjere prezent ishin "M [redacted] nga [redacted]" dhe "Z [redacted] F [redacted] i njohur si Persha". A [redacted] ishte prezent dhe ishte jashte tek nje mur; te dy babe e bir u abuzuan fizikisht; se fundi ai e pa djalin e tij per here te fundit duke e marre. Dëshmitari deklaroi se ne menyre qe te tentonte te binte ne gjurmet e djalit te tij ai kishte shkuar ne zyrat e te pandehurit por nuk kishte arritur ta shihte keshtu qe kishte folur me nje zevendes i cili e kishte derguar tek nje shqiptar i quajtur F [redacted] S [redacted]. Dëshmitari vazhdoi duke thene se ai mori konfirmimin se djali i tij ishte ne stacionin e policise ne Kamenice. Sipas dëshmitarit ai kishte mundur te fliste pese here me te pandehurin ne lidhje me vendndodhjen e djalit te tij, dhe i pandehuri kishte thene, "Ushtria (nga Prishtina) e ka marre". Dëshmitari vazhdoi te thoshte se ai nuk e njihnte S [redacted] ne ditën e incidentit por dikush e kishte permendur emrin "Dragan" ndersa sulmuesit ishin ne shtepi dhe pastaj ai e kishte pare ate njehere me arme automatike afer zyres se te pandehurit.

Pastaj dëshmitari deklaroi, "e vetmja rrugë për të zbuluar se si u vra djali im është ta detyrojmë të pandehurin të flasë".

Dëshmitari dha një përshkrim të detajuar të kthimit të trupit të djalit të tij nga liqeni. Dëshmitari më vonë deklaroi se ai nuk kishte përshkruar më parë agresorët e asaj dite si forcat "ushtarake, paramilitare dhe çetnike".

I pandehuri deklaroi se dëshmitari i ishte ankuar atij gjatë luftës që ushtria i kishte marrë djalin tij dhe vetëm pas lufte kur dëshmitari kish ardh për me e pa me KFOR-in dëshmitari për të herën e parë dyshoi që i pandehuri ishte përgjegjës për vdekjen e djalit të tij.

Dëshmitari përfundoi duke thënë se "nëse ky burrë nuk dënohet, atëherë fëmijët e gjyqtarëve do të kenë fatin e djalit tim".

Në gjykimin e trupit gjykues, ata që e morën prej shtëpie dhe e vranë A [redacted] Th [redacted]. Ndërsa ka disa prova nga dëshmitari që A [redacted] Th [redacted] u mbajt në Stacionin e policisë në Kamenicë pas marrjes së tij nga shtëpia, kjo provë e vetme nuk është aq bindëse sa duhet për trupin gjykues për t'u bazuar mbi të. Është evidente prej përgjigjes përfundimtare të tij që dëshmitari ishte shumë emocional dhe armiqësor me të pandehurin. Trupi gjykues nuk mund të arrijë në përfundimin se identifikimi i D [redacted] S [redacted] ishte korrekt, pasi ai nuk e ka njohur para ditës në pyetje por vetëm ka dëgjuar emrin "D [redacted]". Në këto rrethana trupi gjykues beson se dyshimi shkon në të mirë të të pandehurit.

B [redacted] K [redacted]¹⁹ deklaroi se më 11 maj 1999 ajo ishte në fushat pranë fshatit të saj Rogacice me burrin e saj në monentin kur arritën shtatë policë. Ata kishin automata dhe

¹⁸ PGJ 23.07.02.

¹⁹ TM 06.08.02.

po trokisnin nëpër dyert e shtëpisë. Policia u përball me burrin e saj N [REDACTED] K [REDACTED] dhe pas kësaj ata e morrën në një shtëpi. Menjëherë pasi ajo dëgjoji disa të shtëna, shtëpitë u dogjën. Policia shkoi dhe pak më vonë ajo gjeti trupin e burrit të saj në një dhomë të komshiut të saj; ata e kishin rrahur dhe më pas e kishin qëlluar.

Dëshmitarja deklaroi se në shumë raste, i pandehuri i kish marrë në pyetje djemtë e saj. Ata ishin thirrur dhe marrë në stacionin e policisë ku ishin rrahur dhe kthyer në shtëpi. Dëshmitarja deklaroi se ajo i kish thënë të pandehurit "hajde me policët e tjerë" për të arrestuar djemtë e saj, dhe më vonë tha se ajo nuk e kish parë në fakt atë "unë i dëgjova zërin". Pas këtij ndryshimi të përshkrimit dëshmitarja ndryshoi dëshminë e saj duke thënë se ajo ajo nuk i kish parë djemtë e saj të arrestoheshin por vajzat e saj i kishin treguar për këtë.

Në rastin kur u vra burri i saj policët kishin vënë shami të zeza në fytyrë. Dëshmitarja nuk mundi të japë ndonjë arsye se përse ishte vrarë burri i saj, por deklaroi se pas ngjarjes fshatarët kishin gjetur në rrugë një copë letër ku ishin shkruar emrat e disa burrave të fshatit.

T [REDACTED] K [REDACTED]²⁰ konfirmoi se fshati u sulmua në kushte që përputheshin me dëshmitarin paraardhës. Ajo përshkroi sulmuesit si "tetë paramilitarë apo policë". Ata pyetën njëriun e saj, N [REDACTED] për vendndodhjen e dy djemve të tij, B [REDACTED] dhe R [REDACTED]. Ajo u detyrua të lëshojë shtëpinë ndërsa N [REDACTED] u mbajti aty; vetëm pak më vonë kishte shumë të shtëna dhe kur ata që sulmonin lëshuan fshatin, familjet u kthyen në shtëpi, disa prej të cilave ishin djegur dhe gjetën aty N [REDACTED] të vrarë.

Ndërsa lidhur me atë se kush ishte përgjegjës për këtë masakër, dëshmitarja deklaroi se ajo kish dëgjuar se urdhëri për të vrarë ata që ishin shënuar në copën e letrës të gjetur pas sulmit, erdhi "prej Kamenice".

L [REDACTED] K [REDACTED]²¹ deklaroi se më 11 maj 1999 ai ishte në shtëpinë e tij në Rogacice. Katër persona me maska e kishin thirrur. Ai u kontrollua dhe ju kërkua dokumenti i identifikimit. Ata nxorrën listën dhe e pyetën për emrin. Personat që mbanin maska po kërkonin B [REDACTED] dhe R [REDACTED] K [REDACTED], emrat e të cilëve ishn në listë. Ata pyetën se ku ndodhej shtëpia [REDACTED], e cila u përkiste B [REDACTED] dhe R [REDACTED].

Personat e detyraun t'i shoqërojë për të gjetur shtëpinë. Gjatë rrugës me katër personat me maska u bashkuan edhe tre të tjerë dhe një i katërt pasi ata kaluan urën në qëndër të fshatit. Gjatë rrugës dëshmitari tha që ishte rrahur, fyer dhe kërcënuar edhe me familjen e tij.

Kur arritën tek shtëpia, personat hynë brenda dhe urdhëruan gruan dhe fëmijët të dilnin jashtë. Dëshmitari dëgjoji të shtëna brenda shtëpisë. Më vonë ai mësoi se N [REDACTED] K [REDACTED] ishte vrarë në bodrumin e shtëpisë nga ku vinin të shtënat. Ai nuk e kish parë vetë se kush

²⁰ TM 06.08.02.

²¹ TM 02.12.02.

e vrau N [REDACTED] K [REDACTED]. Ai shtoi se personat me maska kishin veshur uniforma ushtarake por ai nuk mundi të thotë se prej nga ishin ata.

B [REDACTED] K [REDACTED]²² nga Rogacice deklaroi se më 11 maj 1999 një numër i madh “forcash paramilitare dhe polici ushtarake” qëndronin pranë fshatit. Ai konfirmoi deklaratën e dy dëshmitarëve të mëparshëm në lidhje me incidentin duke përfshirë faktin që të gjithë agresorët ishin me maska, përveç njërit. Dëshmitari përshkroi se si ishte vrarë babai i tij nga ata persona dhe më vonë deklaroi se ai ishte marrë më pyetje nga i akuzuari vite më parë dhe që vëllai i tij dhe të tjerë ishin maltrajtuar gjatë viteve 90 për shkak të aktivitetit të tyre humanitar. Sipas dëshmitarit ai kishte pësuar dhunë fizike nga duart e të pandehurit në raste të mëparshme. Dëshmitari deklaroi se policia serbe kishte shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut mbi ata që ankoheshin për sjelljen e policisë duke përfshirë dhe dëshmitarin.

I pandehuri mohoi të ketë keqtrajtuar dëshmitarin.

Ndërsa trupi gjykues pranon që dëshmitari thotë të vërtetën në lidhje me keqtrajtimin e mëparshëm të tij nga i pandehuri, kjo nuk mund të merret si bazë për të arritur në përfundim që i pandehuri ka qënë përgjegjës për për ngjarjet e 11 majit 1999. Në mundësi të provave që tregojnë lidhjen midis këtyre ngjarjeve dhe të pandehurit, konkluzioni i vetëm është që fajësia e tij nuk është provuar.

Trupi gjykues pranon që incidenti ka ndodhur qënësist siç përshkruhet nga këta dëshmitarë dhe që Nevzati është vrarë nga agresorët. Megjithatë, për trupin gjykues kjo provë nuk provon që i akuzuari është përfshirë duke komanduar, apo marrë pjesë aktivisht në ngjarjet e përshkuara.

Z [REDACTED] I [REDACTED]²³ nga Kopernica deklaroi që në mëngjesin e 11 majit 1999 policia rrethoi shtëpinë e saj në Kopernice. Burri i saj, Ismaili u nxorr jashtë. Një polic u afrua me një copë letër në dorë dhe kërkoi të dijë se ku ishte shtëpia e I [REDACTED] I [REDACTED] doli nga shtëpia dhe atij ju lidhën duart e pastaj e çuan poshtë kodrës. Pak më vonë ajo dëgjoi tre të shtëna dhe rreth orës 1:00 pasdreke gjeti trupin e burrit të saj. Ajo konfirmoi se copa e letrës në duart e njërit prej agresorëve doli dhe në gazetë. Ajo deklaroi se burri i saj kishte një pozitë të respektuar dhe influencë në komunitet, karakteristikë kjo që ishte e pranishme dhe në rastin e shumë viktimave të tjera të ngajrjes së 11 majit 1999.

E [REDACTED] D [REDACTED]²⁴ ishte gruaja e R [REDACTED] L [REDACTED] dhe të dy ishin në shtëpi në fshatin Hogosht më 11 maj 1999. Tregimi i saj për atë ditë është se dy persona me uniformë hynë në shtëpinë e saj dhe pyetën nëse kishte armë aty. Personi atëherë e hoqi mënjane burrin e saj. Njëri nga personat thërritej “D [REDACTED]”. Asaj i treguan një copë letër ku ishin shkruar një numër emrash midis të cilëve dhe emir i të shoqit dhe i thanë që këta ishin emrat e

²² TM 30.09.02.

²³ TM 06.09.02.

²⁴ TM 30.09.02.

personave që do të likujdoheshin. Brenda disa orësh asaj i dogjën shtëpinë dhe dëgjoi një numër të shtënash.

Dëshmitarja deklaroi, "Personi që qëndron prapa kësaj është Momcillo Trajkovic" por nuk dha ndonjë arsye për të mbështetur deklarin e saj përveç që ai ishte shef i policisë në Kamenicë. Ajo i dha gjykatës një numër emrash nga lista e shkruar dhe deklaroi se nga ata emra vetëm burri i saj dhe M [REDACTED] S [REDACTED] ishin vrarë.

Dëshmitarja vazhdoi me deklarin se ajo nuk mund të thoshte nëse agresorët ishin policë apo ushtarakë dhe mbrojtja theksoi që në hetim dëshmitarja kishte përshkruar uniformat si uniforma ushtarake.

R [REDACTED] B [REDACTED]²⁵ deklaroi se më 11 maj 1999 ai u arrestua në fshatin Hogosht. Ai përshkroi keqtrajtime të vëllait të tij, sipas tij nga "forcat speciale". Ai tha që ata të gjithë bëheshin pesë persona të armatosur rëndë dhe një prej tyre ishte rom. Ai ishte akuzuar si anëtar i UÇK-së, gjë që ai e mohoi, dhe ndaj të tjerëve u bënë akuza të ngjashme, si kërcënim për të shtënë mbi ata që ishin të lidhur me UÇK-në. Dëshmitari pa që një prej këtyre njërzëve kishte një listë emrash dhe vazhduan t'u venë flakën shtëpive dhe të dhunojnë atë dhe të tjerët.

Sipas dëshmitarit, në fund të ditës ai u çua nga fshati në stacionin e policisë në Gjilan, më një makinë ku ishin 32 paramilitarë dhe të tjerë. Gjatë udhëtimit mbi R [REDACTED] L [REDACTED] u kryen dhe maltrajtime të tjera. Dëshmitari shpjegoi qartësisht që ngajrjet në fshat atë ditë kanë qënë vërtet të tmerrshme. Ndërsa dëshmitari deklaroi që ai njohu disa nga personat përgjegjës ai nuk deklaroi që ndonjë prej tyre të kishte ardhur prej stacionit policor të Kamenicës, por që më të rrezikshmit vinin prej Ferizajt. Përsëri, edhe ky dëshmitar si të tjerët deklaroi se ai e konsideronte dëshmitarin përgjegjës pasi ai ishte shefi i policisë në Kamenicë. Dëshmitari deklaroi se një i quajtur J [REDACTED] K [REDACTED] që beshej se jetonte diku në Prishtinë, i kish thënë atij se e kish parë të pandehurin në fshat atë ditë. Ndërsa gjykata nuk mundi të konfirmojë këtë, u konkludua që kjo provë e dëgjuar nuk ishte sa duhet e besueshme për t'u pranuar.

S [REDACTED] K [REDACTED]²⁶ nga Karaceva deklaroi se ai po ecte nëpër male kur u ndalua nga policë me uniforma policore dhe disa me maska. Ai dëgjoi disa të shtëna dhe pak më vonë zbuloi trupat e R [REDACTED] dhe të M [REDACTED] aty afër. Dëshmitari nuk njohu asnjë prej policëve. Dëshmitari pranoi se policët ishin nga stacioni policor i Kamenicës por pa dhënë asnjë arsye bindëse për këtë opinion.

I [REDACTED] S [REDACTED]²⁷ gjithashtu foli mbi ngajrjet e ndodhura më 11 maj 1999 në fshatin Hogosht.

Ai tha se midis 10 ose 10.30 paradite forcat Sërbe të përbëra prej ushtrisë dhe policisë filluan të sulmojnë fshatin. Disa ishin me uniforma kamuflazhi dhe kishin të shkruajtur

²⁵ TM 11.10.02

²⁶ TM 11.10.02

²⁷ TM 17.10.02

Polici dhe disa prej tyre ishin me maska. Dëshmitari besonte se ata ishin policë nga rajoni dhe kishin vënë maska për të fshehur identitetin e tyre. Policia kishte një listë me emrat e personave që do të ekzekutoheshin. Dëshmitari besonte, por për këtë nuk dha arsye për ta mbështetur, se lista ishte përgatitur në stacionin policor në Kamenicë. Lista përmbante 11 emra dhe shtëpitë e 10 personave nga lista, ishin djegur.

Rreth 11.15 të së njëjtës ditë forcat Sërbe rrethuan shtëpinë e tij por dëshmitari arriti të ikë. Ai mësoi më vonë nga nëna e tij se forcat sërbe i vunë flakën shtëpisë dhe morrën babain e tij M [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe R [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR]. Mëngjesin tjetër ai mësoi se babai i tij dhe R [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] ishin ekzekutuar.

Dëshmitari deklaroi gjithashtu se ai e dinte se i akuzuari ishte shef policie. Ai besonte se i akuzuari ishte përgjegjës për të gjitha vrasjet në territorin e Kamenicës sepse ai ishte shefi i policisë.

Sh [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR]²⁸ dëshmoi lidhur me ngajrjet e 11 majit 1999 të ndodhura në fshatin Kopernice. Ai deklaroi që rreth 10.30 paradite 7 policë ardhën në oborrin e tij. Ata kërkonin të gjithë anëtarët e familjes së tij. Pastaj ata i kërkuan atij vendndodhjen e I [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR], kushëri ky i dëshmitarit. Tre nga oficerët e policisë qëndruan në shtëpinë e tij. Katër të tjerët e shoqëruan duke i drejtuar armën për të kërkuar shtëpinë e I [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR] e cila ishte rreth 60 metra nga shtëpia e dëshmitarit.

Kur arritën në shtëpinë e I [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR], dëshmitari e pa atë të shoqëruar nga oficerët e policisë dhe me pranga. Sipas dëshmitarit shefi i policisë u jepte urdhëra oficerëve të policisë me radio për të eliminuar I [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR]. Në kohën kur jepeshin urdhërat me radio dëshmitari ishte pranë policit të cilit i jepeshin urdhërat. Ai tha se ai e njihte mirë të akuzuarin dhe ata jetonin në fshatra fqinj. Ai mendonte se shefi i policisë që dha urdhëra me radio mund të ishte vetëm i akuzuari pasi sipas tij askush tjetër veç të akuzuarit nuk mund të japë një urdhër të tillë një polici.

Dëshmitari dëgjoji të shtëna dhe mësoi më vonë se I [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR] ishte vrarë. Trupi i tij u kthye rreth orës 3 pasdite.

Gjykata konkludoi se njohja e pretenduar e zërit të të akuzuarit në radio nuk ishte e besueshme derisa dëshmitari thejsht supozoi se derisa zëri ishte i një komandanti, ai doemos duhet të ketë qënë zëri i të akuzuarit, konkluzion ky që për trupin gjykues është komplet i pasigurt.

Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR]²⁹ gjithashtu foli për ngajrjet që ndodhën më 11 maj 1999 në fshatin Hogosht. Ai deklaroi se atë ditë ai dhe familja e tij u dëbuan nga shtëpia e tyre, së cilës iu vu zjarri. Ai shpjegoi se ai dhe familja e tij kanë qënë gjithmonë të ndjekur nga rregjimi sërb dhe ai kishte vuajtur sepse e kundërshtonte këtë rregjim.

²⁸ TM 12.11.02

²⁹ TM 02.12.02.

Në ditën kritike ai nuk i pa agresorët që hynë në fshat. Ai ju referua listës së emrave që iu dha atij prej njëfarë S [REDACTED] N [REDACTED] J [REDACTED] nga Dardica. Mendohej se lista u gjet nga një bari dy ditë pasi ndodhën ngjarjet. Dy persona, emrat e të cilëve ishin në atë listë ishin kapur dhe ekzekutuar. Ata ishin R [REDACTED] L [REDACTED] dhe M [REDACTED] S [REDACTED]. Ai shtoi se emri i tij kish qënë gjithashtu në atë listë.

Dëshmitari e njohte të akuzuarin prej kohës që i akuzuari punonte si mësues dhe gjithashtu më vonë kur ai u bë shef policie. Dëshmitari tha që ai i shmangej të akuzuarit pasi ai kish vuajtur persekutimin e rregjimit sërb.

B [REDACTED] K [REDACTED]³⁰ deklaroi se ai ishte në fushat pranë Karaveces së Epërme më 11 maj 1999 kur pa një makinë policie të vinte dhe disa policë dolën jashtë. Ai po fliste me një polic, i cili i tha se duhej të shkonte me ta pasi në të kundërt ata do e vrisnin dhe do i digjinin shtëpinë. Ai deklaroi se pastaj ai pa policinë të nxirrte me forcë prej makinës R [REDACTED] dhe M [REDACTED] nga Hogoshti dhe ata u vranë që të dy 100 metra larg tij në kohën kur ai po mbahej nga një polic tjetër i cili kishte radio dhe ai dëgjoji aty fjalët “i vramë të dy gentë”. Dëshmitari deklaroi se ai ish rrahur aq keq sa nuk mund të lëviste për dy javë.

Dëshmitari deklaroi se ai besonte se gjithçka ishte bërë me urdhër të të pandehurit. Trupi gjykues nuk mundi të mbledhë asnjë arsye për të mbështetur këtë qëndrim përveç që i pandehuri ishte “shef policie” dhe kështu që konsiderohej përgjegjës çdo masakër të ndodhur në komunë.

Në këtë rrethana, pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave në lidhje me ngjarjet e 11 majit 1999, Gjykata konkludoi se R [REDACTED] L [REDACTED], M [REDACTED] S [REDACTED], N [REDACTED] K [REDACTED], A [REDACTED] Th [REDACTED] dhe I [REDACTED] L [REDACTED] janë rrëmbyer dhe vranë nga ata të cilët i morrën prej shtëpive të tyre më 11 maj 1999, por nuk mundi të arrijë në përfundimin që i pandehuri shfaqet si pjesëmarrës drejtpërdrejt apo indirekt në këto ngjarje.

Provat e dëshmitarëve të tjerë mbi detyrat e të pandehurit dhe përfshirjen e tij të dyshuar në veprat e përmendura në aktakuzë.

R [REDACTED] R [REDACTED]³¹ deklaroi se ai e ka njohur të akuzuarin për 20 vjet dhe e ka ditur që ai ishte shef i policisë në Kamenicë. Sipas tij stacioni i policisë ishte nën komandën e të akuzuarit. Para fillimit të bombardimeve të NATO-s i akuzuari shoqëronte policinë nga Kamenica në pjesë të tjera të Kosovës çdo dy javë. Oficerët e policisë transportoheshin me autobuza dhe kur ata ktheheshin në Kamenicë i pandehuri i përshëndeste me fjalët “mirëseerdhët trima”. Kurdo që ai e shihte të akuzuarin me oficerë të tjerë policie të zbriste nga autobuzi ai ishte i veshur si civil, por ai nuk e kishte parë kurrë të hynte në ndonjë nga këta autobuzë. Ai e dinte që i akuzuari ka qënë inspektor për sigurimin kombëtar në 1998 dhe sipas tij i akuzuari ka qënë i përfshirë në ndjekjen e njerëzve që nuk ju pëlqente rregjimi sërb.

³⁰ TM 30.09.02

³¹ TM 26.06.02

Përsa i përket detyrave të të pandehurit si shef policie, dëshmitari deklaroi se ai ishte në dijeni të detyrave të shefit të policisë. Forcat e policisë ishin nën komandën e shefit të policisë. Ai e dinte këtë pasi ai ka qënë kryetar i komunës së Kamenicës nga 1995 në 1998 dhe ai vlerësoi se gjatë periudhës së luftës në 1999 policë nga Kamenica keqtrajtonin qytetarët.

Dëshmitari deklaroi që nuk ka pasur as aktivitet ushtarak dhe as luftë në rajon në këtë kohë dhe prandaj nuk kishte nevojë për policinë të keqtrajtonte njerëzit. Ai vlerësoi se si shef i policisë *“asgjë nuk mund të bëhej pa urdhërat e tij (të pandehurit)”*.

Dëshmitari dha shumë prova indirekte të ngjarjeve në Komunën e Kamenicës gjatë luftës dhe për këtë tha se *“populli”* fajëson të pandehurin për këto ngjarje me dyshimin që policia e Kamenicës ishte përgjegjëse.

Për trupin gjykues kjo provë nuk ishte as ndihmëse dhe as e besueshme: ajo kishte të gjitha karakteristikat e një dëshmie të grumbuluar nga një numër burimesh të veçanta dhe përmbante pak prova të rëndësishme bazuar në njohjen e vet të akuzuarit. Për më tepër dëshmia e këtij dëshmitari u zhvlerësua thëlbësisht nga një dëshmitar tjetër shqiptar, N ■ SH ■, i cili dha prova tepër të rëndësishme me kurajo dhe pa marrë parasysh sigurinë e tij personale.

N ■ SH ■³² deklaroi se ai ka punuar për të pandehurin në Kamenicë për pothuaj katër vjet, nga 1989 në 1994. Më pas ai vazhdoi të takohej me të pandehurin me raste dhe deklaroi se *“Nga fundi i 1994 në 1999 unë nuk kam qënë në dijeni të ndonjë ankese mbi sjelljen e tij”*. Dëshmitari përshkroi detyrat e të pandehurit si *“shef i punonjësve të administratës....Ai është marrë me rregjistrim makinash dhe lëshim lejesh për vozitje”*.

Dëshmitari vazhdoi duke thënë që periudhën e luftës ai e kish kaluar në banesën e tij në Kamenicë deh në Hogosht gjithashtu ku jetonte familja e tij, megjithëse ai nuk ka qënë në fshat më 11 maj 1999. Ai deklaroi se gjatë luftës ai *“nuk ka qënë në dijeni të asgjëje në lidhje me Momcillo Trajkovic”*. Më tej ai deklaroi se pasi kishte dhënë dëshminë në shqyrtimin e parë kryesor atij I kish ndodhur një tentativë për t'i marrë jetën.

Trupi gjykues e vlerëson si tepër të rëndësishëm dëshminë e këtij dëshmitari. Dëshmitari dha prova panvarësisht tentativës për t'i marrë jetën. Ai nuk e ekzagjeroi dhe trupi gjykues e vlerësoi atë si shumë të pavarur. Trupi gjykues e konsideron dëshminë e tij si tepër ndihmëse për konkluzionin e përgjithshëm të trupit gjykues që nuk ka prova të mjaftueshme fajësie ndaj të pandehurit në lidhje me akuzat 1 deri në 11 të përfshira në këtë aktakuzë.

A ■ R ■³³ deklaroi se ai e njeh shumë mirë të pandehurin. Ky dëshmitar deklaroi se ai ka qënë shef rajonal i sigurisë me bazë në Gjilan deri në 1990 kur ai u nxorr nga puna forcërisht nga rregjimi serb. Ai deklaroi se si shef i punëve të brendshme në Kamenicë, i

³² TM 17.12.02

³³ TM 18.07.02

pandehuri ishte përgjegjës për rendin publik dhe që veprimet mund të ndërmerreshin nga policia vetëm me dijeninë e tij.

Dëshmitari dorëzoi një kopje të urdhërit të 7 prillit 1999 të lëshuar nga Presidenti i Republikës së Sërbisë, i cili i zgjeronte kompetencat e OUP në kohë lufte. Dëshmitari ishte i vendosur të vlerësonte që i pandehuri duhej të ketë ditur lidhur me veprimet e policisë me uniformë por më vonë në dëshminë e tij ai pranoi se i pandehuri ishte shef i sigurisë publike dhe si i tillë nuk ishte me uniformë. Ai është ngarkuar me hetimin e krimit të rëndë, personat e humbur dhe çështje dokumentesh; sipas tij, panvarësisht kësaj policët me uniformë nën urdhërat e komandantit, i përgjigjeshin gjithashtu dhe të pandehurit.

Për trupin gjykues ky dëshmitar ishte gati t'i jepte një rëndësi të madhe eksperiencës së tij në një pozitë të ngjashëm me atë të të pandehurit, të cilin e ka përfunduar në 1990. Dëshmitari nuk ishte në pozicionin nga ku mund të fliste mbi ndonjë incident gjatë luftës dhe ai nuk mund të tregonte kush ishte ndryshimi që kish ndodhur në detyrat dhe përgjegjësitë e të pandehurit si rezultat i përfshirjes së ushtrisë në rajonin e Kamenicës, nëse kishte një të tillë. Lidhur me këtë fakt dëshmuar shumë dëshmitarë të tjerë. Për këtë arsye trupi gjykues vlerësoi se nuk do të ishte e drejtë të gjykoje të pandehurin sipas supozimeve të këtij dëshmitari.

M■■■■ F■■■ K■■■³⁴ ka qënë inspektor policie deri sa u nxorr nga puna në 1990. Ai hodhi dyshimetse gjatë viteve të para të '90-ta i pandehuri e kishte fyer dhe maltrajtuar atë në më tepër se një rast. Dëshmitari deklaroi se ai ishte dënuar nga gjykata me një vit burg. Dëshmitari deklaroi gjithashtu se pozita e të pandehurit si shef policie kërkonte që ai të kishte diejri për çka ndodhte në komunë: dëshmitari pranoi që i akuzuari kishte punuar në sigurimin publik ndërsa dëshmitari kishte punuar në sigurimin e shtetit.

Trupi gjykues arriti në përfundimin se dëshmitari nuk dha prova të vlefshme për asnjë nga akuzat. Veçanërisht, trupi gjykues vëren se dyshimet për sjellje të keqe të të pandehurit lidhen me një kohë shumë më përpara dhe të mohuara nga i pandehuri ato nuk e ndihmojnë trupin gjykues të arrijë konkluzion mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.

D■■■ G■■■³⁵ foli lidhur me punën e Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Gjilan dhe detyrat e të akuzuarit. Dëshmitari është officer policie dhe e ka njohur të akuzuarin prej 1 janarit 1999. Atë ditë dëshmitari u emërua si Shef i Sekretariatit të Punëve të Brendshme në Gjilan (SUP). Ai ishte shefi i të akuzuarit, i cili ishte Shef i Punëve të Brendshme në Kamenicë (OUP), i akuzuari duhet t'i raportonte atij.

Dëshmitari deklaroi se njësia organizative e SUP ishte një degë e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Sërbisë (MUP). MUP-i nga ana e saj ishte nën Sigurimin Publik dhe Shtetëror. Ndarja e Punëve të Brendshme ishte përgjegjëse për çështje administrative si dokuemntet e identifikimit, lejet e vozitjes dhe pashaportat. Kishte gjithashtu seksione të

³⁴ TM 23.07.02

³⁵ TM 03.02.03 (I dëgjuar në Beograd)

veçanta të policisë të ndara në sigurinë publike, trafikun, drejtoria kriminale, departamenti i zjarrit, policia kufitare dhe drejtoria administrative. Sipas dëshmitarit edhe në fillim të luftës OUP-i vazhdoi me detyrat normale. Aktivitetit ditor i të akuzuarit konsistonte në organizimin e punës, identifikimin e problemeve dhe zgjidhjen e çështjeve disiplinore.

Dëshmitari tha se ai ishte në dijeni se kishin ndodhur krime të rënda në Komunën e Kamenicës. Ai shtoi se hyrja e NATO-s "krijoi një atmosferë ku instiktet bazë u forcuan". Ai mohoi që njerëz me uniforma policie kishin kryer masakrat në fshatrat e Kamenicës. Ai tha gjithashtu se nëse këto masakra do të kishin ndodhur, ai do të kishte qenë në dijeni të tyre. Ai nuk kishte arsye për të besuar se punët e brendshme kishin mbuluar ndonjë masakër. Ai pranoi se si kryetar i SUP-it në Gjilan ai duhej të informohej për çdo vepër penale të rëndë të ndodhur në këtë zonë. Nëse i akuzuari do të kishte dëgjuar për të tilla ngjarje atëherë do të ishte detyrë e tij t'i raportonte për to.

Ndërsa trupi gjykues e shqyrtoi me kujdes provën, por duhet theksuar se nuk ka prova bindëse për të kundërtën.

D [REDACTED] S [REDACTED]³⁶ dha dëshmi mbi punën e tij në OUP në Kamenicë. Ai deklaroi se gjatë gjysmës së parë të 1999 ai ishte anëtar i shërbimit policor brenda OUP-it në Kamenicë. Ai ishte komandant i stacionit të policisë dhe ishte në krye të pothuaj 100 policëve. Ai ka pasur kontakt ditor me të akuzuarin. Ka pasur një njësi e cila ishte duke marrë raporte të përditshme mbi krimet serioze që kanë ndodhur në fshatrat gjatë luftës. Ai shtoi se policia nuk ka bërë krime mizore në fshatra. Ai vet nuk ishte në dijeni të mizorive. Po të kishte marrë raporte mbi mizori të tilla, ai do të kishte ndërmarrë masa përkatëse. Ai nuk ka mundur ta shpjegojë se pse fshatarët po bënin deklarata inkriminuese kundër policisë. Bile edhe pas shpalljes së luftës, detyrat e policisë mbesin të njëjta.

Sa i përket forcave policore, dëshmitari ka deklaruar se nuk ishte në dijeni që dikush kishte të veshur uniformë ilegale, porse nuk ka mundur ta përjashtojë një mundësi të tillë. Dëshmitari kishte mbledhje të punës me të akuzuarin dhe se ai dhe i akuzuari ie informonin tjetrin. Ai gjithashtu e ka informuar të akuzuarin lidhur me aktivitetet e policisë. Edhe pse i akuzuari kishte autorizim ta ndalojë dëshmitarin mos të ndërmarrë ndonjë aksion nëse ndonjë urdhër i tillë ka qenë në pajtim me rregullat e policisë, i akuzuari nuk ka dhënë kurrë një urdhër të tillë. Policia në Kamenicë ishte e detyruar t'i dorëzojë SPB-së (SUP-it) në Gjilan raporte me shkrim. I akuzuari kishte për detyrë përpilimin e raporteve për zonën e tij.

Edhe pse trupi gjykues kishte dyshime të mëdha në lidhje me dëshminë e këtij dëshmitari i cili kishte qenë i implikuar sic kanë qenë të përzier në disa incidente në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe disa dëshmitarë në këtë rast, nuk kishte asgjë në dëshminë e tij që e implikonte të akuzuarin në mizoritë që kanë ndodhur në fshatrat e të cilat janë përmbledhur dhe përmendur më lartë.

³⁶ TM 03.02.03 (dëgjuar në Beograd)

R [REDACTED] J [REDACTED]³⁷ ka deklaruar se ka qenë zëvendës i shefit të SPB-së (SUP-it) në Gjilan edhe para dhe pas luftës në vitin 1999. Ai e ka vërtetuar tregimin e të akuzuarit sa i përket natyrës dhe numrit të detyrave që ai i kishte. Dëshmitari ka deklaruar se nuk ka pasur raporte të rëndësishme për ngjarje të tmershme në regjionin e Kamenicës edhe pse kishte dëgjuar se ushtria kishte “zbatuar një operacion në komunën e Kamenicës për të cilin ishte thënë se kishte pasur 4 apo 5 viktime”.

Sipas mendimit të trupit gjykues, dëshmitari i ka hequr pjesët e padëshirueshme të deklaratës së vet lidhur me ngjarjet për të cilat ishte në dijeni porse është e pamundur të thuhet se ato që i ka thënë e implikojnë në një farë mënyre të akuzuarin.

B [REDACTED] F [REDACTED]³⁸ ka deklaruar se e ka takuar të akuzuarin për të parën herë më 1985 dhe se ka qenë kryetar i komunës së Kamenicës nga 1993 deri kur është larguar nga Kosva në gusht të vitit 1999. Dëshmitari ka deklaruar se ishte në dijeni të disa mizorive në fshatërat lokale gjatë luftës mirëpo se nuk kishte dëgjuar se kush inkriminohej për përgjegjësi. Ky kishte pranuar një numër të delegacioneve të shqiptarve nga fshatërat mirëpo se nuk kishte dëgjuar kurrë se ato po i inkriminonin policinë e rregulltë serbe të jetë përfshirë, Sipas tij, policia kishte qenë “forcë stabilizuese”.

Trupi gjykues ka gjetur se ky dëshmitarë po e fliste të vërtetën kur thot se nuk ka marrë ankesë mbi mizoritë që i ka bërë policia serbe. Sipas mendimit të trupit gjykues, kjo nuk është sepse policia serbe nuk kishte qenë e përfshirë në ndonjë incident të tillë porse është shenjë se forcat ushtarake dhe paramilitare shiheshin të kenë qenë duke komanduar cdo gjë.

T [REDACTED] R [REDACTED]³⁹ ka folur për punën e tij në stacionin policor të Kamenicës. Ky ka deklaruar se ka punuar si pastrues në stacionin policor të Kamenicës për 35 vite më radhë. E ka njohur të akuzuarin dhe ka shtuar se sjellja e të akuzuarit ka qenë sjellje normale gjatë muajve që i kanë paraprirë luftës. Sipas tij, i akuzuari ka pasur marrëdhënje të mira me bashkësinë vendase duke përfshirë aty edhe shqiptarët. Dëshmitari ka deklaruar se nuk e kishte parë të akuzuarin kurrë në uniformë policore.

Trupi gjykues ka konsideruar se dëshmia e këtij dëshmitari i jep pak mbështetje propozimit se i akuzuari në përgjithësi nuk ishte në zë të keq në atë vend para lufte.

N [REDACTED] S [REDACTED]⁴⁰ gjithashtu ka folur për punën e saj në stacionin policor të Kamenicës. Ajo ka deklaruar se ka punuar si pastruese në stacionin policor të Kamenicës për 17 vite me radhë. Ajo ka filluar të njohë ta akuzuarin kur ky ishte shef i stacionit. Kjo nuk ka mundur të thotë asgjë për natyrën e raporteve që i akuzuari ka pasur me bashkësinë vendase duke përfshirë aty edhe shqiptarët. Ajo nuk e kishte parë kurrë në zyrën e të akuzuarit ndonjë polic në uniformë.

³⁷ TM 03.02.03 (i dëgjuar në Beograd)

³⁸ TM 03.02.03 (i dëgjuar në Beograd)

³⁹ TM 07.102.03

⁴⁰ TM 05.02.03

Trupi gjykues ka konsideruar se dëshmia e kësaj dëshmitareje nuk i ka ndihmuar trupit gjykes.

Gjykata gjithashtu ka dëgjuar nga një ish monitor⁴¹ i Misionit monitorues të Missionit verifikues të Kosovës/ OSBE-së (OSCE/KVM) i cili ka dhënë dëshmi mbi kontaktet e tij me të akuzuarin dhe serbë të tjerë vendas gjatë periudhës katër mujore prej 2 janar 1999 dhe 19 marsit 1999. Identiteti i këtij dëshmitari është mbajtur sekret sipas nenit 289 par. 3 të LPP-së. Shkurt, dëshmitari ka pasur detyrën e zyrtarit ndërlidhës së MPB (MUP-it) regjional dhe si tillë ka pasur kontakte me një numër të personave në MPB(MUP) dhe DPB (OUP) në regjionin Gjilan/Kamenicë. Ai e kishte kuptuar se i akuzuari e kishte rangun e “Majorit” dhe e ka bërë të qartë se stacioni policor i Kamenicës ka qenë nën njësinë e Gjilanit.

Dëshmitari ka dhënë dëshmi të rëndësishme në dy lëmi të vecanta të lëndës. Së pari, ai ka deklaruar, *“Mund të them qartë se asgjë nuk më ka ra në sy gjatë periudhës kur unë kisha këtu që më ka bërë të mendoj ose që do të më bënte të mendoj se i akuzuari po vepron jashtë asaj që unë e kam kuptuar që ka qenë detyrë e tij”*. Me fjalë të tjera, ai s’ka dëgjuar asgjë të keqe lidhur me të akuzuarin. Së dyti, ai ka deklaruar se kur është larguar nga Kosova më 18 mars, *“ekipet tona që po vepronin në teren kishin parë një numër të madh të forcave të UJ-së (VJ) dhe SPB-së (MUP) duke hyrë në Kosovë nga ana e Serbise e që janë vendosur pak a shumë nëpër tërë regjionin.”*

Integriteti i këtij dëshmitari nuk vihet në pyetje. Derisa ai nuk ka mundur t’i ndricojë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ngjarjet incriminuese në aktakuzë, dëshmia e tij e ndihmon mbrojtjen duke tentuar të tregojë se i akuzuari nuk ishte në zë për gjëra të pazakonshme gjatë dy muajve që i kanë paraprirë luftës dhe se, ajo që është më e rëndësishme, ai numër i madh i forcave ekstra ushtarake dhe të sigurimit është vendosur nga Serbia në regjionin e Gjilanit pak përpara se mizoritë të fillojnë. Ky fakt e mbështet fuqimisht pikëpamjen e trupit gjykues në atë mënyrë se ajo që ka ndodhur në fshatrat e regjionit gjatë luftës është bërë nga duart e personave që nuk kanë qenë vendas dhe në atë masë që policia vendase duke u përzier, e gjithë kjo ka mundur të jetë bërë nën nxitje dhe nën kontrollin e autoriteteve më të larta dhe më të largëta.

Konkludim. Shkurt, vlerësimi i drejtë i dëshmive të dëshmitarëve në këtë kapitull ka bërë që trupi gjykues të konkludojë se nuk ka asgjë që në mënyrë të konsiderueshme e inkriminon të akuzuarin dhe se ekziston një pjesë emadhe e dëshmive të besueshme që e mbështet pikëpamjen se ngjarjet në fshatrat nuk janë udhëhequr lokalisht e, kryesisht, as nuk janë ekzekutuar nga policia lokale. Ky konkludim vetvetiu con në mënyrë të pashmangshme kah pikëpamja se edhe nëse i akuzuari ka ditur për disa apo për të gjitha ngjarjet ose para ose pasi që ato të ndodhin, do ishte pothuajse a pamundur se ai do të kishte qenë në gjendje t’i ndal që ato të mos ndodhin apo që mëpastaj t’i hetojë ato t’i dënojë ata që janë përgjegjës.

⁴¹ TM 05.02.03

Incriminimi i tentim vrasjes (2) së 27 qershorit 1999

Ka qenë vetëm në aktakuzën e ndryshuar që Prokurori publik ndërkombëtar e ka akuzuar të akuzuarin me akuzë të dytë lidhur me A ■ P ■. Prokurori publik ndërkombëtar nuk ka kërkuar që të bëjë ankesë në aktgjykimin e gjykimit të parë. Në bazë të kësaj, trupi gjykues ka konsideruar që prokurori nuk mund të kërkojë dënim edhe për një pikë shtuese për shkak të parimit të reformatio in pieus.

Sa i përket akuzës së tentim vrasjes së M ■ F ■, gjykata ka dëgjuar një numër dëshmitarësh këtë që vijon.

M ■ F ■⁴² ka deklaruar se më 27 qershor 1999 ai së bashku me A ■ P ■ e kanë ngritur flamurin shqiptar në stacionin policor të Kamenicës. Pasi që flamuri është ngritur, ai e ka parë të akuzuarin në ballkonin e tij në katin e tretë të ndërtesës përballë stacionit policor. Dëshmitari ka filluar të largohet sepse e ka parë të akuzuarin duke mbajtur dicka. Pastaj ka dëgjuar një rafal të shtënash dhe ishte goditur nga një plumb në këmbën e djathtë. Më vonë ka shtuar se ka qenë pushkë automatike ajo që ky e kishte parë tek te i akuzuari në ballkon. Distanca në mes të tij dhe ë akuzuarit kur ai ka shtënë ishte dikund 20 deri 30 metra. Ka deklaruar pozitivisht se ka qenë i akuzuari ai që ka shtënë dhe askush tjetër. E ka identifikuar të akuzuarin sepse e kishte parë atë më herë, meqë Kamenica është vend i vogël. Gjatë momenteve precize të të shtënave askush nuk kishte armë përvec të akuzuarit. Me shpinë ka qenë i kthyer kah akuzuari kur janë ndezur të shtënat. I ka kaluar pesë ditë në spital si pasojë e lëndimeve.

Kur është marrë në pyetje nga avokati mbrojtës lidhur me atë se pse nuk e kishte përmendur se i akuzuari ka thënë “ja ku janë atje, ia qifsha nënën e tij, do ta vras” ai ka deklaruar se i kishte harruar disa gjëra. Sipas tij, të shtënat kanë ardhur nga kati i tretë. Kur ka marrë vesh se do të goditej, i ka thënë shokut të tij se i duhet të largohet. Nuk ka qenë askush tjetër në ndonjë ballkon tjetër gjatë asaj kohe aty. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se ia ka raportuar këtë akt penal KFOR-it amerikan dikund një apo një muaj e gjysmë më vonë sepse ka qëndruar në shtëpi për tu shëruar dhe se telefoni i tij nuk ka punuar gjatë asaj kohe.

I akuzuari ka deklaruar se më 27 qershor 1999 ai ishte në fshatin e tij Carakovc nga ora 7 e mengjezit me shokun e tij N ■ dhe se ishte kthyer në ora 9 të mbrëmjes. Ai gjithashtu ka deklaruar se gjatë shqyrtimit të mëparshëm dëshmitari ka deklaruar se është shtënë kah ai nga ballkoni kurse se tani thot nga dritarja. Ai gjithashtu e përmend shikimin në vendin e ngjarjes me 15 janar 2000 kur prokurori e kishte marrë atë dhe dëshmitarin tek një pjesë a banesës së tij dhe se atje prokurori i kishte treguar me dorë disa banesa pa ballkone duke e pyetur dëshmitarin se nga ku kishte gjuajtur ai. Ai ka shpjeguar se banesat pa ballkone janë të kthyer kag jugu kurse banesa e tij është e kthyer kah përdimi dhe kishte ballkon.

⁴² TM 22.07.02

A P⁴³ ka deklaruar se atë ditë ai ka shkuar në stacionin policor të Kamenicës në shoqëri të shokut të tij M F. Ata e kishin ngritur një flamur shqiptar në vendin ku kishte qëndruar flamuri serb. Në një moment një njeri ka dalur në ballkon përballë stacionit të policisë. Po bërtiste, “Si është e mundur për terroristin shqiptar të vendosë atë flamur atje”. Fjala që ai ka përdorur ishte “Albanski”.

Dëshmitari dhe shoku i tij kanë filluar të ecin drejtë kopshtit të fëmijëve. Ai e ka dëgjuar se si po e mbushte armën, meqë e tërë zona ishte e qetë. Ai mëpastaj kishte vërejtur të akuzuarin në dritare. Ai kishte filluar të gjuajë në drejtim të tyre. Plumbat kishin kaluar përreth këmbëve të dëshmitarit. Shoku i tij M ishte goditur. Dëshmitari ka shtuar se e kishte njohur të akuzuarin për disa vite më radhë. Kur dëshmitari ka përmendur se shoku i tij është goditur në gjunin e djathtë ai ka përdorur fjalën shqipe “kamben” e cila do të thotë e tërë këmba ose shputa. Dëshmitari ka parë vetëm një pjesë të armës që është përdorur për të shtënë.

Në përgjigje të dëshmisë i akuzuari ka përdorur një alibi dhe ka deklaruar se më 27 qershor 1999 që ishte e dielle, ai gjindej në fshatin e lindjes nga ora 7 e mëngjezit deri në ora 8 e mbrëmjes. Emri i fshatit është Cerovac. Ai gjithashtu ka shpjeguar se ka qëndruar në banesën e tij përballë stacionit të policisë deri më 7 shtator 1999. Ai ka kominkuar edhe me serbët edhe me shqiptarët. KFOR-i e kishte intervistuar atë tri apo 4 heerë lidhur me këtë inkriminim. Ai ka theksuar se gjatë kohës kur kishte qëndruar në banesën e tij në mes qershorit dhe shtatorit 1999 askush nuk ka folur asgjë për të shtënat.

XH K⁴⁴ ka deklaruar se më 27 qershor 1999 kishte dëgjuar disa të shtëna që ndizeshin nga ballkoni i katit të ndërtesës në të cilën ai gjindej mu poshtë banesës së të akuzuarit. Ai e ka dëgjuar të akuzuarin se si po e thirrte dikënd. Ai ka dëgjuar dicka duke u përmendur lidhur me hendeqe. Kur është pyetur se a ka dëgjuar dicka tjetër, ai është përgjigjur se e ka dëgjuar të akuzuarin duke thënë “ Nuk mund bile ta marr me mend se në mes të ditës dikush mund ta ngrisë flamurin shqiptar në ndërtesën e policisë” Ai e kishte parë flamurin shqiptar.

Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se më vonë e ka marrë vesh se dikush është lënduar. Kur është pyetur se a ka shikuar në drejtim të ballkonit kur i ka dëgjuar të shtënat, ai është përgjigjur se ka qenë e pamundur të shikojë sepse terasat ishin përmi njëra tjera tjerën. Kur është pyetur nga avokati mbrojtës, ai ka përmendur se gëzhojat e plumbave janë gjetur në rrugë në distance prej dy metrave nga terasa. Ai gjithashtu ka deklaruar se në atë kohë askush tjetër nuk ka jetuar në katin në të cilin gjindej i akuzuari.

Si përgjigje e kësaj dëshmie, i akuzuari ka deklaruar se ka qenë i befasuar se dëshmitari mund të vijë dhe të japë një dëshmi të tillë kundër tij. Ai ka përsëritur se atë ditë ai gjindej jashtë fshatit në shoqëri të fqinjët të tij S N. Ai gjithashtu ka theksuar se dikubd 100 metra larg nga ndërtesa në të cilën gjindej banesa e tij gjindej pika kontrolluese e KFOR-it. Meqë ai kishte jetuar në banesë të veten deri më shtator 1999, ai e ka parë si të cuditshme se askush nuk i kishte bërë KFOR-it raport mbi të shtënat.

⁴³ TM 06.03.02

⁴⁴ TM 17.01.03

S█████ N█████⁴⁵ ka deklaruar se më 28 qershor 1999 ishte dita e Vidovdanit dhe se një ditë më parë, që do të thotë i 27, ai e kishte shoqëruar të akuzuarin deri në fshatin e tij. Ata kanë marrë disa thasë me miell dhe disa gjëra tjera me vete. Dikund kah mesdita, ai ka shkuar tek shtëpia e vjehhrit të të akuzuarit. Ishin nisur për në Kamenicë nga fshati në ora 7 apo 7:30 të mbrëmjes. Atë ditë kishte ngrënë darkë në shtëpinë e të akuzuarit.

Z█████ J█████⁴⁶ ka deklaruar se me 27 qershor 1999, një ditë para ditës së Vidovdanit, ajo gjindej në fshatin Carakovc dhe se edhe i akuzuari ishte atje. Ajo ka deklaruar se një ditë më pas ajo dhe tjetri kishin festuar ditën e shenjtit në banesën e të akuzuarit në Kamenicë. Sipas saj, i akuzuari ishte në fshat gjatë mengjezit herët të ditës 27, duke i ngarkuar thasët në traktor.

Sic u përmend më lart, i akuzuari vetvetiu e kishte dhënë një deklaratë të njëjtë më 6 mars 2003.

Trupi gjykues ka pasur dobi nga shikimi në vendin e ngjarjes më 7 mars 1999, i cili ka treguar se banesa e të akuzuarit ka qenë ballë përballë stacionit policor dhe me një pamje të qartë kah vendi ku pala e dëmtuar dhe shoku i tij kishin ngritur flamurin.

Trupi gjykues gjithashtu ka pranuar si dëshmi raportet mjeksore lidhur me trajtimin mjekësor që M█████ F█████ e kishte marrë më 27 qershor 1999 në spitalin e Gjilanit.

Vlersimi i dëshmimeve lidhur me tentim vrasjen

Trupi gjykues nuk ka pasur dyshim se kjo vepër është vertetuar. Përveç dëshmimeve të palës së dëmtuar dhe të shokut të tij, gjykata ka nxjerrë dobi nga provat e Xh█████ K█████ i cili ka qenë dëshmitar i pavarur gjatë pranisë së akuzuarit në banesën e tij në kohën relevante, i cili e kishte dëgjuar të akuzuarin duke thënë në zë fjalë ofenduese lidhur me veprimet e palës së dëmtuar dhe të shokut të tij, se kishte dëgjuar të shtënat dhe ka konfirmuar se askush në atë kohë nuk ka jetuar në atë kat të banesës përveç të akuzuarit dhe se kishte gjetur plumba të armës përmbi banesë.

Kjo provë fuqimisht e përforcon dëshminë e palës së dëmtuar dhe të shokut të tij dhe në mënyrë fatale e dobëson dëshminë e të akuzuarit dhe të dëshmitarëve të tij alibi.

Në bazë të kësaj, gjykata është e bindur se i akuzuari, i motivuar nga urrejtja etnike dhe paragjykimi ka shtënë dhe goditur M█████ F█████ në rrethanat e përshkruara duke i shkaktuar plagë serioze këmvës së M█████ F█████.

Në këto rrethana natyra e veprimeve të të akuzuarit e shoqëruar me fjalët që i ka thënë e të cilat janë dëgjuar nga Xh█████ K█████ tregojnë pa asnjë pikë dyshimise i akuzuari ka

⁴⁵ TM 03.02.03 (i dëgjuar në Beograd)

⁴⁶ TM 02.04.03

pasur për qëllim t'i vrasë të dy të rinjtë shqiptarë. Për arsyet e përmendura më lartë, gjykata jep dënim vetëmn në rastin lidhur me M [REDACTED] F [REDACTED].

Akuza e posedimit të paligjshëm të armëve

Me pajtim të palëve, gjykata e fut në procesverbal deklaratën e B [REDACTED] H [REDACTED] të dhënë para gjykatësit hetues më 20 shtator 1999⁴⁷.

Në atë deklaratë, dëshmitari ka deklaruar se, edhe pse nuk i kujtohet data e saktë, dikund gjatë muajit shtator, së bashku me dy ushtarë të tjerë, kishte trokitur në derë të një shtëpie në Kamenicë me qëllim që të kryejë bastisje aty meqë dikush e kishte informuar KFOR-in se një person ishte plagosur. Personi menjëherë e kishte mohuar të ketë pasur armë në shtëpinë e tij dhe thotë se tërë armët ia kishte dorëzuar KFOR-it. Personi pastaj ia kishte trguar ushtarit certifikatën e lëshuar nga KFOR-i me të cilën konfirmohej fletdorzimi i një AK 47 dhe një revoleje.

Bastisja e shtëpisë është bërë pastaj dhe derisa po bëhej, i akuzuari papritmas kishte thënë se ka dicka për të treguar. I akuzuari pastaj ka treguar një shportë nga purfundi i krevatit dhe nga e cila kishte nxjerrë një AK 47, dy bomba (të cilat trupi gjykues i interpreton si granata) dhe 300 plumba. I akuzuari pastaj ka deklaruar se këto gjëra nuk i kanë takuar atij porse se *"i ka gjetur në banesën e tij tridhjetë minuta më parë"*. I akuzuari është arrestuar

Tregimi i të akuzuarit lidhur me këtë çështje ka qenë se ky i ka marrë ato armë nga banesa e T [REDACTED] D [REDACTED] i cili në kohën relevante kishte një banesë një kat më lart sesa banesa përmbi banesën e tij në Kamenicë. Sipas të akuzuarit atij *"i ka ndodhur të hyjë në (banesën e D [REDACTED]) derisa po bëhej një vjedhje aty, dhe pastaj unë i kam marrë armët në banesën time"*. I akuzuari ka deklaruar se është përpjekur ta marrë D [REDACTED] që të vijë në gjykimin e parë kryesor porse ka refuzuar.

T [REDACTED] D [REDACTED]⁴⁸ ka deklaruar se i ka pasur armët që janë gjetur në banesë të të akuzuarit dhe se i kanë takuar atij dhe se në atë kohë ishte larguar për të qëndruar me të afërmit e tij dhe se celësat e banesës ia kishte lënë birit të të akuzuarit. Tregimi i tij ka qenë se, edhe pse nuk e ka ditur saktësisht se cka ka ndodhur, ai është i sigurtë se i akuzuari i ka marrë armët në banesën e tij për *"t'i ruajtur ato në të sigurtë"*.

Përvec kësaj, mbrojtja pohon se, edhe nëse gjykata gjen se i akuzuari është gjetur në armembajtje të paligjshme, atij duhet t'i jipet amnistia e cila ishte në fuqi në kohën kur armët janë zbuluar.

Sipas mendimit të trupit gjykues, mbrojtja ndaj kësaj akuze është pa ndonjë substancë. Së pari, armët janë gjetur brenda shportës nën krevatin e të akuzuarit: kjo tregon se ai ka pasur për qëllim dhe se i ka fshehur ato me qëllim që t'i mbajë ato për t'i ruajtur. Së dyti,

⁴⁷ TM 06.03.03

⁴⁸ TM 03.02.03

ai e ka gënjyer eprorin H [REDACTED] kur është ballafaquar së pari lidhur me atë se a ka pasur armë apo jo në banesën e tij. Kjo i tregon trupit gjykues se tregimi i të akuzuarit se i ka gjetur armët pak më parë nuk qëndron. Më në fund, gjykata nuk e ka pranuar dëshminë e T [REDACTED] D [REDACTED]; ky dëshmitar është i pasigurt dhe jo i bindshëm në tregimin e tij. Gjykata prandaj ka konkluduar se i akuzuari ka qenë në posedim të paligjshëm të armëve.

Sa i përket çështjes së aministisë, është e vërtetë se menjëherë pas luftës përpjekje të mëdha janë bërë nga ana e KFOR-it për të bërë çmilitarizimin e individëve në Kosovë. Argumenti i mbrojtjes ka qenë se Shteti (fjala është për autoritetet serbe apo jugosllave) ua kishin dhënë armët civilëve për qëllim që të mbrojtjes dhe se shteti me veprimet e veta civilëve ua kishte imponuar *“një lloj të posedimit të obligueshëm të armë ve dhë të municionit”*⁴⁹. Edhe nëse pranohet një argument i tillë si legjitim në lidhje me një një person i cili pohon se armët që i ka në posedim ia dhënë atij nga ana e shtetit, gjykata nuk e pranon që ky argument mund të zbatohet për armë që i kanë burimet dikund tjetër. Në këtë rast, i akuzuari nuk ka sygjyer se armët në fjalë i janë dhënë atij nga shteti, dhe gjykata konkludon se tregimi i të akuzuarit është i pavërtetë kur thot se armët i ka gjetur vetëm gjysëm ore para se apartamenti i tij është bastisur. Në këto rrethana, gjykata konkludon se argumenti i përmendur nga mbrojtja nuk është relevant.

I akuzuari ka qenë në gjendje të tregojë një certifikatë nga KFOR-i në lidhje me armët tjera që ai i ka dorëzuar. Në bazë të kësaj, ai e ka ditur se për t'u përputhur me dispozitat e aplikueshme të amnistisë në Kosovë në atë kohë, rrjedha korekte e veprimit ka qenë që t'ia dorëzoi armët autoriteteve. Fshehja me qëllim e armëve ka vazhduar të jetë e paligjshme dhe e tregon qëllimin e të akuzuarit t'i fshehë armët paligj dhe t'i mbajë ato në posedim, dhe në bazë të kësaj ai është fajtor për këtë vepër penale.

DËNIMI

Në mungesë të ndonjë ankese nga ana e Prokurorit, gjykata është e lidhur me dënimet e mëparshme të bëra nga aktgjykimi i parë i Gjykatës së Qarkut. Në aktgjykim, gjykata e ka dënuar të akuzuarin me vepër penale të krimit të luftës (i rekualifikuar si krime kundër njerëzisë), dhe ka shpallur dënimin maksimum me 20 vite burg. Dënimet e dhëna për veprat e tentim vrasjes dhe posedimit ilegal të armëve (3 vite dhe 4 muaj secila nga këto vepra) janë thjeshtë dhënë së bashku me dënimin kryesor. Trupi gjykues i pari nuk ka bërë mbledhje të dënimit sa i përket këtyre veprave penale të fundit.

Në këto rrethana, kjo gjykatë konsideron se sipas nenit 48 par. 1 të LPP-së i akuzuari duhet të dënohet me një bashkim dënimi më pak se 3 vite e 4 muaj. Sipas mendimit të trupit gjykues ky dënim është me të vërtetë mëse i matur për këto vepra.

Trupi gjykues nuk ka mundur të shohë ndonjë rrethanë lehtësuese për këto vepra.

⁴⁹ Fjala përfundimtare e z. Jokanović, 28.05.03, faqe 19

Në bazë të kësaj, trupi gjykues ka shpallur po të njëjtat dënime si ato të trupit të parë gjykues, mirëpo për arsyet e përmendura konsideroj se dënimi i përbashkët prej 3 viteve dhe 3 muajve është dënim korrekt, i cili duhet të jipet për këto vepra penale.

Procesmbajtëse:
Robina Struthers



Kryetari i trupit gjykues:
Timothy Clayson

Gjykata e Qarkut në Gjiçan
28 nëntor 2003

Këshillë juridike: Lejohet ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Përkthyen: T.K., B.Sh., G.G., Gj.Z.